| 11:00 - 12:00 | **Periudha 3** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 4** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 3** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 4** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | |
| 12:00 - 12:30 | Pushim Dreke | | | | |
| 12:30 - 1:30 | **Periudha 5** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 6** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 5** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 6** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Asinkron Kohë për Projekte dhe Mësim<br>Udhëtime Virtuale në Terren<br>Klasa për Institucione Kulturore |
| 1:30 - 1:45 | Pushim | | | | |
| 1:45 - 2:45 | **Periudha 7** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | **Periudha 7** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | |
| 2:45 - 3:30 | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe e Pavarur | | | | |
| 3:30 - 4:10 | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | |

## Shkolla 9-vjeçare SEI – MODEL ORAR për ELs në EPL 1&2

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| 9:00-9:15 | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** Kohë Shtesë për Zhvillim Komuniteti |
| 9:30-10:30 | **Periudha 1: ESL** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 2: ESL** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 1: ESL** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 2: ESL** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | |
| 10:30-11:00 | Kohë Pushimi & Punë e Pavarur | | | | **Asinkron Të Mësuar Shtesë ESL** |
| 11:00-12:00 | **Periudha 3** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 4** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 3** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 4** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | |
| 12:00-12:30 | Dreka Pushim | | | | |
| 12:30-1:30 | **Periudha 5** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 6** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 5** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 6** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Asinkron Kohë për Projekte dhe Mësim<br>Udhëtime Virtuale në Terren<br>Klasa për Institucione Kulturore |
| 1:30-1:45 | Pushim | | | | |
| 1:45-2:45 | **Periudha 7** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | **Periudha 7** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | |
| 2:45-3:30 | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | | | | |
| 3:30- 4:10 | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | |

## Shkolla 9-vjeçare SEI – MODEL Orari për ELs në EPL 3-5

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| 9:00-9:15 | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** | **Klasa e Kujdestarisë** Kohë Shtesë për Zhvillim Komuniteti |
| 9:30-10:30 | **Periudha 1** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 2** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 1** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 2** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | |
| 10:30-11:00 | Pushim & Independent ëork Ora | | | | **Asinkron I mësuar Shtesë ESL** |
| 11:00-12:00 | **Periudha 3: ESL** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 4** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 3: ESL** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 4** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | |
| 12:00-12:30 | Dreka Pushim | | | | |
| 12:30-1:30 | **Periudha 5** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 6** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 5** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | **Periudha 6** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Asinkron Kohë për Projekte dhe Mësim<br>Udhëtime Virtuale në Terren<br>Klasa për Institucione Kulturore |
| 1:30-1:45 | Pushim | | | | |
| 1:45-2:45 | **Periudha 7** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | **Periudha 7** Sesione Sinkron & Kohë Pune Shtesë | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | |
| 2:45-3:30 | Kohë Pune në Bashkëpunim dhe të Pavarur | | | | |
| 3:30- 4:10 | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | Sesione me Ndihmë të Shtuar | |

<u>Strukturat e qëllimshme për një të mësuar të suksesshëm në distancë në shkollën e mesme përfshijnë:</u>

- Periudha më të gjata në klasë dhe më pak në ditë për të mundësuar një të mësuar më thellësisht

të përqendruar

- Oraret e përditshme u lejojnë nxënësve/eve për të marrë pjesë në regjitstrime të dyfishta, edukim teknik karriere dhe mundësi për internshipe
- Fleksibilitet në shkollë në kohën kur një periudhë realizohet, për të mundësuar një periudhë dyfishe në klasa përparuese, si edhe disa mëisme të karrierës profesionale teknike *(me përjashtimin e periudhës së 6 & 7, që janë të përcaktuara për të mundësuar Programin e Kolegjit të Hershëm dhe 100 Djema në Kolegj – Early College & 100 Males to College Programing)*
- Përbërja e klasës do të përfshijë mundësi për mësimdhënie të drejtpërdrejtë dhe kohë për mësimdhënie shtesë, si edhe të përfundojë në një mënyrë të sinkronizuar
- Mësuesit/et do të monitorojnë progresin e nxënësit/es gjatë kohëve shtesë të të mësuarit, për të kontrolluar nivelin e kuptueshmërisë dhe të rimësohet aty ku është e nevojshme
- Mundësi ditore për nxënësit/et për të marrë mbështetje nga mësuesit/et dhe nga staf tjetër mështetës

- Sesione ndihme pas shkolle

## Orari për Nxënës të Gjimnazit

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| **7:20 - 8:35** (75 min) | **Periudha 1** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Periudha 1** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë/projekte**<br>**Udhëtime Virtuale në Terren**<br>**Klasa për Institucione Kulturore** |
| **8:35 - 8:50** (10 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | | |
| **8:50- 10:05** (75 min) | **Periudha 2** | **Periudha 4** | **Periudha 2** | **Periudha 4** | |
| **10:05 - 10:35** (30 min) | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | |
| **10:35 - 11:05** (30 min) | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | |
| **11:05 - 12:20** (75 min) | **Periudha 3** | **Periudha 5** | **Periudha 3** | **Periudha 5** | |
| **12:20 - 12:28** (8 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | |
| **12:28 - 1:43** (75 min) | **Periudha 6** | **Periudha 7** | **Periudha 6** | **Periudha 7** | |
| **1:45 - 2:20** (40 min) | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | |

# Orari për Nxënësit/et e Gjimnazit Teknik Worcester

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| **7:20 - 8:35** (75 min) | **Periudha 1/9** | **Periudha 4/12** | **Periudha 1/9** | **Periudha 4/12** | **Punë e Pavarur në Klasë/projekte** |
| **8:35 - 8:50** (10 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | |
| **8:50 - 10:05** (75 min) | **Periudha 2/10** | **Periudha 5/13** | **Periudha 2/10** | **Periudha 5/13** | |
| **10:05 - 10:35** (30 min) | **Punë e Pavarur** | **Punë e Pavarur** | **Punë e Pavarur** | **Punë e Pavarur** | |
| **10:35 - 11:05** (30 min) | **Dreka** | **Dreka** | **Dreka** | **Dreka** | |
| **11:05 - 12:20** (75 min) | **Periudha 3/11** | **Periudha 6/14** | **Periudha 3/11** | **Periudha 6/14** | |
| **12:20 - 12:28** (8 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | |
| **12:28 - 1:43** (75 min) | **Periudha 8/16** | **Periudha 7/15** | **Periudha 8/16** | **Periudha 7/15** | |
| **1:45 - 2:20** (40 min) | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | |

# Gjimnazi SEI – MODEL Orari për ELs në EPL 1&2

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| **7:20 - 8:35** (75 min) | **Periudha 1: ESL** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Periudha 1: ESL** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Asinkron Të mësuar Shtesë ESL** |
| **8:35 - 8:50** (10 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | | |
| **8:50 - 10:05** (75 min) | **Periudha 2** | **Periudha 4: ESL** | **Periudha 2** | **Periudha 4: ESL** | |
| **10:05 - 10:35** (30 min) | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë/Projekte Udhëtime Virtuale në Terren**<br><br>**Klasa për Institucione Kulturore** |
| **10:35 - 11:05** (30 min) | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | |
| **11:05 - 12:20** (75 min) | **Periudha 3** | **Periudha 5** | **Periudha 3** | **Periudha 5** | |
| **12:20 - 12:28** (8 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | |
| **12:28 - 1:43** (75 min) | **Periudha 6** | **Periudha 7** | **Periudha 6** | **Periudha 7** | |
| **1:45 - 2:20** (40 min) | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | |

# Gjimnazi SEI – MODEL Orari për ELs në EPL 3-5

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| **7:20 - 8:35** (75 min) | **Periudha 1** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Periudha 1** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Asinkron Të mësuar Shtesë ESL** |
| **8:35 - 8:50** (10 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | | |
| **8:50-10:05** (75 min) | **Periudha 2: ESL** | **Periudha 4** | **Periudha 2: ESL** | **Periudha 4** | |
| **10:05 - 10:35** (30 min) | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë** | **Punë e Pavarur në Klasë/Projekte**<br><br>**Udhëtime Virtuale në Terren**<br><br>**Klasa për Institucione Kulturore** |
| **10:35 - 11:05** (30 min) | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | |
| **11:05 - 12:20** (75 min) | **Periudha 3** | **Periudha 5** | **Periudha 3** | **Periudha 5** | |
| **12:20 - 12:28** (8 min) | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | Ndërrimi/Përgatitja e Klasës | |
| **12:28 - 1:43** (75 min) | **Periudha 6** | **Periudha 7** | **Periudha 6** | **Periudha 7** | |
| **1:45 - 2:20** (40 min) | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | **Sesione me Ndihmë të Shtuar** | |

## Mbështetje për Nxënës/e të Gjuhës Angleze (ELs) në Modelet e Propozuara

## MODELI HIBRID

Modeli i programit për një gjuhë angleze intensive *A Sheltered English Immersion* (SEI) dhe programe dy-gjuhësorë do të jenë të mundur për të gjithë ELs-të me Nivel Anglishteje (EPL) 1-5. Mësimi i Anlgishtes së Shprehur si një Gjuhë e Dytë (ESL) do të ndërfutet në ditën e çdo nxënësi/eje, në përputhje me nevojat e tyre të gjuhës. Të mësuarit i ESL-së dhe i përmbajtjes do të jenë të dyja sinkron dhe asinkron, duke krijuar sa më shumë të jetë e mundur mundësi për një ndërveprim të drejtpërdrejtë, sidomos për të ardhurit rishtas.

Si do të mbështeten të gjithë ELs-të në këtë model?

- Duke ofruar në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, si sinkron ashtu edhe asinkorn, mësimdhënie të ESL-së.
- Zgjeruar bashkë-mësmdhënien si një përqasje mësimdhënieje për të maksimizuar bashkëpunimin ndërmjet mësueseve/ëve dhe të rrisë nivelin e të mësuarit të gjuhës dhe të përmbajtjes, si në të mësuarin e ESL, ashtu edhe në atë të përmbajtjes.
- Përdorimi i mësimdhënies ballë-për-ballë për të siguruar njohuri të background-it dhe për të siguruar mundësi për ndërveprim.
- Të bërit e mundshëm e mbështetjes indivduale për nxënësit/et, për të cilët/cilat kanë nevojë dhe të mundësohen kontrolle të rregullta me mësuesit/et.
- Ofrimi i eksperiencave të të mësuarit për të promovuar gjuhën: grupe me dy nxënës/e, grupe të vogla, aplikacione regjistrimi për praktikimin e gjuhës verbale dhe prezantime në klasë të regjistruara më parë.
- Rrit angazimin e familjes EL gjatë leximit, shkrimit dhe aktiviteteve verbale të gjuhës.
- Sigurimi i mbështetjes teknologjike për nxënësit/et dhe familjet kur është e nevojshme.
- Grupimi strategjik i nxënësve/eve për të maksimizuar kohën e mësimdhënies.
- Sigurimi i PD-ve me cilësi për mëuesit/et dhe drejtuesit/drejtueset në të mësuarin në distancë për ELs.
- Përmirësim për të rritur aksesin në EL, qasjen në analizimin e të dhënave EL dhe strategjive të mësimdhënies, që do të mbështesë platformën e përmbajtjes së mësimdhënies.

Përveç të sipërpërmendurave, ne do të zgjerojmë përpjekjet për mbështetje dhe do të rrisim marrjen në konsideratë të nën-grupeve të ELs-së si në vijim: nxënësit/et SLIFE, ELs-të në nën-grupe (nxënësit/et me paaftësi të konsiderueshme të vendosur në klasa thellësisht të ndara, duke pasur parasysh nevojat e tyre të të mësuarit akademik dhe të atij social-emocional) dhe ELs-të të niveleve EPL 1 dhe 2.

- Këtyre nxënësve/eve do t'u ofrohen më shumë mundësi mësimdhënieje të drejtpërdrejta (4 ditë me mësim të drejtpërdrejtë dhe 1 ditë më mësimdhënie në distancë asinkron).
- Gjatë ditëve me modelin e drejtpërdrejtë, nxënësit/et do të marrin mësime eksplicite ESL në bazë të nivelit të tyre EPL. Të mësuarit e lëndëve të tjera do të koordinohen gjithashtu gjatë ditëve të mësimit të drejpërdrejtë.
- Ne do të përdorim gjithashtu *Imagine Learning* (Imagjinimin e të Mësuarit), një platformë në internet që mbështet gjuhën dhe shkrim e lexim, si një mbështetje shtesë për të mësuarin asinkron.

- Mësuesit/et do të mundësojnë më shumë mbështetje të individualizuar sipas nevojës.
- Sapo një listë e nxënësve/eve pjesëmarrës/e në modelin hibrid do të konfimohet në bashkëpunim me familjet, një vendim do të merret lidhur me vendin/dhomën për të mësuarin e drejtpërdrejtë. Ne do të konfirmojmë dhe koordinojmë personelin, përfshi edhe nevojat për transport. Plane të sigurisë dhe një program specifik do të krijohen me data dhe me orare.

## NË DISTANCË

Një model i programit SEI dhe programe dygjuhëshe do të jenë të disponueshme për të gjithë ELs-të në nivelet 1-5 të EPL-së. I mësuar explicit ESL do të planifikohet në ditën e secilit/secilës nxënës/e, sipas nevojave të tyre gjuhësore. Mësimdhënia ESL dhe e përmbajtjes do të jetë sinkron katër ditë në javë dhe asinkron një ditë në javë, për të maksimizuar mundësitë e të mësuarit dhe mundësitë për ndërveprim të drejtpërdrejtë, veçanërisht për të ardhurit rishtas.

Si do të mbështeten të gjithë ELs-të në këtë model?

- Do të vazhdojmë të ofrojmë udhëzime sistematike, të qarta ESL, në mënyrë sinkronike katër ditë në javë dhe në mënyrë asinkronike një ditë në javë.
- Do të zgjerojmë bashkë-mësimdhënien si një qasje mësimore për të maksimizuar bashkëpunimin e mësuesve/eve dhe për të forcuar mësimin e gjuhës dhe përmbajtjes, si në ESL, ashtu edhe në të mësuarin e përmbajtjes.
- Do të përdorim mësimdhënien e drejtpërdrejtë për të mbledhur informacione mbi background-in dhe për të ofruar mundësi për bashkëveprim.
- Do të sigurojmë më shumë mundësi sinkron for për ELS Themelore (nxënësit/et në EPL 1 & 2).
- Do të mundësojmë mbështetje individuale për nxënësit/et, të cilët/cilat kanë nevojë dhe po ashtu kontrolle të rregullta me mësuesit.
- Mundësimi i përvojave mësimore të qëllimshme, për të promovuar gjuhën: grupe nxënësish/esh me dy persona, grupe të vogla, aplikacione regjistrimi për praktikimin e gjuhës verbale dhe regjistrim paraprak i prezantimeve në klasë.
- Do të rrisim angazhimin e familjes EL gjatë leximit, shkrimit dhe aktiviteteve të gjuhës verbale.
- Do të mundësojmë mbështetje teknologjike për nxënësit/et dhe familjet kur është e nevojshme.
- Do të grupojmë nxënësit/et në mënyrë strategjike për të maksimizuar kohën e mësimdhënies.
- Do të bëjmë të mundur programin *Imagine Learning* për të gjithë të ardhurit e rinj dhe atyre ELs në EPL 1 & 2, një platformë në internet që mbështet gjuhën dhe shkrim-leximin.
- Do të mundëosjmë PD me cilësi të lartë për mësuesit/e dhe drejtorët/eshat në mësimdhënien në distancë për Els.
- Përmirësim për të rritur aksesin në EL, qasjen në analizimin e të dhënave EL dhe strategjive të mësimdhënies, që do të mbështesë platformën e përmbajtjes së mësimdhënies.

Përveç të lartpërmendurave, do të zgjerojmë përpjekjet për mbështetje dhe do të rrisim marrjen në konsideratë për nën-grupet në vijim të ELs-së: Nxënësit/et me Arsimim Formal të Kufizuar ose të Ndërprerë (SLIFE), nxënësit/et EL në parametrat të nën-ndara (nxënësit/et me aftësi të konsiderueshme të kufizuara, të vendosura në klasa thelbësisht të ndara, duke pasur parasysh nevojat e tyre të të mësuarit akademik dhe social-emocional), si edhe ELs në nivelet EPL 1 dhe 2.

- Nënësve/eve do t'u mundësohen 4 ditë mësimdhënie sinkron në distancë dhe 1 ditë mësimdhënie asinkron.
- Nxënësit/et do të marrin periudha të shumfishta të mësimdhënies eksplicite ESL, në përputhje me nivelin e tyre EPL-së. Të mësuarit e lëndëve të tjera do të koordinohet gjatë ditës.

- Do të mundësohet më shumë bashkëpunim ndërmjet mësuesve/eve, përfshi mësuesit/et ESL, mësuesit/et e përmbajtjeve thelbësore, mësuesit/et e arsimit të veçantë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve.
- Do të përdorim gjithashtu *Imagine Learning*, një platformë në internet që mbështet gjuhën dhe shkrim-leximin, si një mbështetje shtesë për të mësuarit asinkron.
- Mësuesit do të ofrojnë më shumë mbështetje, më të individualizuar, sipas nevojës.
- Mësuesit do të kontrollojnë rregullisht me nxënësit/et për t'u siguruar që të mësuarit dhe nevoja të tjera janë përmbushur.

## Mbështetje për Nxënësit/et me Aftësi të Kufizuara (SWD) në Modelet e Propozuara

Në përputhje me udhëzimet e Departamentit të Arsimit Fillor dhe të Mesëm (DESE), distrikti i shkollës do të sigurojë që nxënësit/et të marrin shërbimet e dokumentuara në Planet e tyre të Edukimit të Individualizuar (IEPs) pavarësisht modelit të të mësuarit, ndërsa ende respektojnë kërkesat aktuale të shëndetit dhe sigurisë.

Udhëzimet e DESE-s kanë nxitur distriktet t'i japin përparësi mësimdhënies së drejtpërdrejtë për dy grupe nxënësish/esh: nxënësit/et në moshë parashkollore dhe ata/ato me nevoja të rëndësishme dhe komplekse. Shkollat Publike Worcester po i bëjnë prioritet të gjithë nxënësit/et me paaftësi. Prandaj është qëllimi ynë të bëjmë çdo përpjekje për të mundësuar një mësimdhënie të drejtpërdretjë për nxënësit/et me nevoja të nivelit të lartë. Nëse nxënës/e të tjerë/tjera janë duke marrë pjesë në modelin hibrid apo në atë në distancë të plotë dhe nëse gjendja aktuale e shëndetit publik e lejon, plani i distriktit përshkruan përparësinë për të ofruar shërbime të drejtëprdrejta për nxënësit/et me nevoja të konsiderueshme, deri në katër ditë në javë me një ditë mësimdhënie në distancë pas Tremujorit 1. (Ju lutemi shikoni "Plani i Qarkut për Rangun e Nevojave të Mbështetjes së Nxënësve/eve të Grupeve B & C dhe ata/ato të Grupit C të të Mësuarit të Drejtpërdrejtë" për më shumë informacion)

Qëllimi i distriktit është t'u sigurojë nxënësve/eve me aftësi të kufizuara mjedise të sigurta të të mësuarit në mjedis më pak kufizues të mundshëm. Nxënësit/et me aftësi të kufizuara duhet të marrin shërbime, ashtu siç përshkruhet në IEP-të e tyre, bazuar në llojin e nevojave të tyre. IEP-të nuk do të modifikohen për të pasqyruar ndryshimet e ofrimit të shërbimeve sipas udhëzimeve të DESE-së. Prindërit/kujdestarët/et do të marrin një përmbledhje të ofrimit të shërbimit të IEP-së, nëse modeli i mësimdhënies ndryshon për fëmijën e tyre.

**Të mësuarit e drejtpërdrejtë për popullsi me nevoja të veçanta**:

Grupe të caktuara nxënësish/esh, të tilla si; nxënës/e të identifikuar me moshë parashkollore dhe nxënës/e me nevoja të konsiderueshme, dhe/ose ata/ato që mësojnë gjuhën angleze, të cilët/cilat e kalojnë 75% të ditës së tyre në mjedise klasash të veçanta, mund të kenë nëvojë për mësimdhënie të drejtpërdrejtë, me qëllim për të adresuar nevojat e tyre individuale të të mësuarit. Shërbimet të posaçme për mësimdhënien do të zbatohen siç përshkruhen dhe bazuar në IEP-në e nënshkruar dhe të pranuara nga nxënësi/ja, për të siguruar që të gjithë Nxënësit/et me Aftësi të Kufizuara (SWD) janë duke punuar me mësuesit/et e tyre dhe/ose ofruesit e shërbimeve, në maksimumin e mundshëm, si edhe janë vlerësuar për të matur progresin dhe nivelet e tanishme të performances, në rast se nevojiten shërbime shtesë,

duke respektuar gjithashtu protokollet aktuale të shëndetit dhe sigurisë

**Si realizohet mbështetja e SWD-eve në këtë model:**

Mësimdhënie e drejtpërdrejtë, që do të ofrohet pas Tremujorit 1 dhe që do të përfshijë zgjidhje fleksibël për të patur një numër sa më të vogël grupesh nxënësish/esh të përzjera, me qëllim për të siguruar që nxënësit/et janë duke marrë shërbime në një mjedis sa më pak kufizues. Kjo mund të përfshijë, kur është e mundshme, ofrimin e shërbimeve më specifike brenda klasës së nxënësit/es, në masën më të madhe të mundshme.

Distrikti e ka gjithashtu të qartë që prindërit/kujdestarët e nxënësve/eve me kushte të brishta mjekësore mund të mos ndjehen të qetë të dërgojnë fëmijën e tyre në shkollë në këtë kohë. Nëse një familje zgjedh vetëm mësimdhënien në distancë ose nëse ka një mandat shtetëror ose lokal që të gjithë nxenësit/et t'i nënshtrohen të mësuarit në distancë, atëherë shkollat dhe distriktet duhet të jenë të përgatitur për të ofruar shërbime nëpërmjet mënyrës së "Udhëzimit dhe Shërbimeve", siç edhe përmendet në IEP-në e nxënësit/es.

Departamenti i Arsimit të Veçantë është i përkushtuar të bashkëpunojë me shkollat dhe familjet për të diskutuar mundësi të ofrimit të shërbimeve, për të marrë pjesë në proceset e të mësuarit në distancë, hibride apo të drejtpërdrejta, në mënyrë që t'u mundësojë qasje edhe SWD-ve, duke pasur parasysh vazhdueshmërinë e marrjes së shërbimeve, që janë të mandatuara për të mundësuar një Edukim Publik me një Çmim të Përshtatshëm (FAPE).

Për të mundësuar një tranzicion të plotë të kthimit në shkollë, është e rëndësishme të kihet parasysh se disa nga nxënësit/et tona me aftësi të kufizuara mund të kenë vështirësi në këtë proces tranzicioni dhe/ose ruajtje rutine. Stafi i edukimit të veçantë është i përkushtuar që të punojë ngushtë me prindërit/kujdestarët për të siguruar një tranzicion të qetë, që i mundëson çdo nxënësi/eje të familjarizohet me hapësirat e tyre të reja të mësimdhënies, me oraret dhe programimin. Kontrolle të vazhdueshme të prindërve do të nxisin angazhimin e nxënësve/eve dhe një komunikimin të qëndrueshëm midis prindërve dhe stafit të shkollës.

Bazuar në udhëzimin e DESE-s, distrikti do të mundësojë kohë shtesë për trajnime, për ata mësues/e, të cilët/cilat do të ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë fizike për nxënësit/et me aftësi të kufizuara në përdorimin e mjeteve shtesë mbrojtëse, që do t'u nevojiten atyre, duke përfshirë veshjet dhe mburoja fytyre njëpërdorimshe, si dhe strategji për të adresuar teknika të de-përshkallëzimit, sigurisë dhe të Institutit të Parandalimit të Krizave (CPI). Plani i distriktit për rihapjen do të adresojë konsideratat e nevojshme shëndetësore dhe të sigurisë për popullatat e veçanta.

## Modele të Mësimdhënies Hibride dhe Shërbime të Edukimit të Veçantë

Mësimdhënia dhe shërbimet do të mundësohen nëpërmjet një modeli hibrid të të mësuarit, me një kombinim të të mësuarit të drejtpërdrejtë dhe në distancë. Shkollat do të jenë të kujdesshme me planifikimin duke respektuar kërkesat për distancimin fizik të mësueseve/eve të edukimit të veçantë shtesë dhe ofruesve të shërbimeve përkatëse, të cilëve do t'u duhet të hyjnë në klasa gjatë gjithë ditës për të ofruar shërbime për nxënësit/et me aftësi të kufizuara.

Departamenti i Arsimit të Veçantë do të punojë ngushtë me shkollat për të hartuar detyra në klasë dhe orare të ofrimit të shërbimeve për nxënësit/et, në mënyrë që ata të marrin shërbime në përputhje me

IEP-të e tyre, në një mjedis sa më pak kufizues. Mësuesit/et e edukimit të veçantë dhe ofruesit e shërbimeve përkatëse do të planifikojnë shërbime në atë mënyrë që të respektohen kërkesat për distancim fizik dhe të shmanget mbivendosja me pjesën tjetër të stafit në klasë ose në mjedisin fizik.

**Në çfarë forme do të mbështeten SWD-të në këtë model?**

- Mësimdhënia e krijuar posaçërisht për IEP-në (SDI) do të zbatohet siç përshkruhet dhe bazuar në IEP-në e nënshkruar dhe pranuar nga nxënësi/ja
- Mësuesit/et shërbimeve përfshirëse dhe burimore për Nevoja të Vçanta të Moderuara duhet të mundësojnë bashkëpunim me mësuesit/et e arsimit të përgjithshëm, për të koordinuar një program që ofron mësimdhënie të specializuar, modifikime, akomodime dhe shërbime siç janë të dokumentuara në IEP-ne e SWD-së.
- Shërbimet përfshirëse për SWD-të mund të duken ndryshe me këtë model, në varësi të strukturës së orarit në secilin nivel. Sidoqoftë, opsionet e ofrimit të shërbimeve duhet të përfshijnë shpërndarjen e shërbimeve dhe akomodimeve sipas IEP-së, si dhe monitorimin e progresit të nevojave akademike dhe në fusha specifike të nxënësit/es.
- Nëse mësuesit/et e edukimit të veçantë ose ofrues të shërbimeve përkatëse nuk janë në gjendje të mundësojnë shërbime për edukimin e veçantë, në atë mënyrë që të respektojë kërkesat për distancimin fizik dhe të shmanget mbivendosja me pjesën tjetër të stafit në klasë ose në mjedisin fizik, këta mësues/e ose ofrues shërbimesh mund të planifikojnë shpërndarjen e shërbimeve nga distanca dhe/ose të mundësojnë tele-terapi brenda shkollës përmes konferencave me video.
- Programet në internet (p.sh., programet e shkruara të individualizuara) do të përdoren për të përmirësuar mësimdhënien.
- Një kombinim ditor i mësimit sinkron dhe asinkron mund të përfshijë video klipe mësimesh.
- Do të realizohen kontrolle të shpeshta, të drejtpërdrejta për të nxitur marrëdhënie që përfshijnë edhe familjet.
- Do të mundësohet mbështetje për të Mësuarin Social-Emocional (SEL) për nxënësit/et dhe familjet, për të adresuar burimet dhe ndërhyrjet.
- Mësuesit/et, specialistët dhe ofruesit e shërbimeve të arsimit të veçantë do të ofrojnë orë pune për prindërit dhe nxënësit/et.

## Modeli i të Mësuarit në Distancë dhe Shërbime të Edukimit të Veçantë

Në një format të mësimdhënies plotësisht në distancë, secilit/secilës nxënës/e do t'i mundësohen shërbimet e posaçme specifike, siç parashikohen në Planin e tyre të Edukimit të Personalizuar (IEP), si edhe një orar për marrjen e shërbimeve të posaçme. Drejtorët/drejtoreshat dhe stafi i arsimit të veçantë do të përcaktojnë mënyrën e ofrimit të shërbimeve. Do të ruhet një komunikim i vazhdueshëm me familjet për të siguruar qëndrueshmëri të mbështetjes, për të promovuar angazhimin e nxënësve/eve. Personi përgjegjës për edukimin e veçantë do të hartojë një orar që promovon realizimin e qëllimeve dhe objektivave të IEP-së. IEP-ja e secilit/secilës nxënës/e do të rishikohet në baza individuale, për të përcaktuar shpeshtësinë e shërbimeve të posaçme. Mundësitë e ofrimit të shërbimeve mund të ndryshojnë dhe të përfshijnë grupe të mëdha, grupe të vogla ose 1: 1

**IEP-të nuk do të modifikohen apo ndryshohen për të reflektuar të mësuarin në distancë. Lutemi të keni parasysh se shpërndarja e shërbimeve për çdo nxënës/e mund të mos jetë e njëjtë për arsye të qëllimeve dhe objektivave individuale të parashikuara në IEP.**

**Si do të mbështeten SWD-të në këtë model?**

- SWD-të do të kenë një pajisje që do të sigurojë aksesin dhe distrikti do të punojë me familjet për të adresuar nevojat e tyre të lidhjes me internet.
- Udhëzime të posaçme të IEP-së do të zbatohen ose dizenjohen bazuar në IEP-në e nënshkruar dhe të pranuar të nxënësit/es.
- Mësuesit/et e shërbimeve përfshirëse dhe burimore të Nevojave të Veçanta të Moderuara duhet të mundësojnë bashkëpunim me mësuesit/et e edukimit të përgjithshëm për të koordinuar një orar që do të mundësojë ofrimin e mësimdhënies së specializuar, modifikimeve, akomodimeve dhe mbështetjes, siç përshkruhet në IEP-të e SWD-ve.
- Shërbimet përfshirëse për SWD-të mund të duken ndryshe me këtë model, në varësi edhe të strukturës së orareve për çdo nivel. Megjithatë, mundësitë e shpërndarjes së shërbimeve duhet të përfshijnë shpërndarjen e shërbimeve dhe akomodimeve të IEP-së, si edhe monitorimin e progresit të nevojave akademike dhe atyre në fusha specifike të nxënësit/es.
- Nëse mësuesit/et e edukimit të veçantë ose ofrues të shërbimeve përkatëse nuk janë në gjendje të mundësojnë shërbime për edukimin e veçantë, në atë mënyrë që të respektojë kërkesat për distancimin fizik dhe të shmanget mbivendosja me pjesën tjetër të stafit në klasë ose në mjedisin fizik, këta mësues/e ose ofrues shërbimesh mund të planifikojnë shpërndarjen e shërbimeve nga distanca dhe/ose të mundësojnë tele-terapi brenda shkollës përmes konferencave me video.
- Mësimdhënie e dizenjuar posaçërisht (SDI) do të mundësohet në grupe të mëdha, grupe të vogla apo në grupe 1:1 nëpërmjet *Zoom* ose *Teams*.
- Programet në internet (p.sh., programet e shkruara të individualizuara) do të përdoren për të përmirësuar mësimdhënien.
- Një kombinim ditor i mësimit sinkron dhe asinkron mund të përfshijë video klipe mësimesh.
- Do të realizohen kontrolle të shpeshta, të drejtpërdrejta për të nxitur marrëdhënie që përfshijnë edhe familjet.
- Do të mundësohet mbështetje për të Mësuarin Social-Emocional (SEL) për nxënësit/et dhe familjet, për të adresuar burimet dhe ndërhyrjet.
- Mësuesit/et, specialistët dhe ofruesit e shërbimeve të arsimit të veçantë do të ofrojnë orë pune për prindërit dhe nxënësit/et.

## Transportimi

Departamenti i Massachusetts-it për Edukimin Elementar dhe Dytësor (DESE) shpërndau udhëzimet lidhur me trasportin më 22 Korrik, 2020. Për t'iu përmbajtur udhëzimeve të DESE-s për transportin distriktit do t'i duhe të ulë kapacitetin në autobuza, të paktën përgjysëm. Ndërkohë që jemi duke ruajtur distancimin fizik prej 2 metrash në klasat tona, jemi në gjendje të mundësojmë një distancë të tillë në autobuz vetëm prej 1 metër. Në përputhje me udhëzimet e DESE-s, Shkollat Publike Worcester planifikojnë të zbatojnë udhëzimet pasuese, duke pritur kërkesa shtesë nga shteti:

- Familjet do të anketohen lidhur me preferencat për trasnportin.
- Nxënësit/et do të përcaktohen të ulen në një ndenjëse dhe kjo ndenjëse do të përcaktohet paraprakisht.
- Nxënësit/et duhet të ulen nga një në çdo radhë dhe të alternohen anët, një nga dritarja dhe një nga brenda, gjë që u mundëson atyre të ruajnë distancën fizike. Fëmijët nga e njëjta familje mund të ulen së bashku dhe të qendrojnë më pranë (p.sh., dy nxënës në një radhë).
- Si të rriturve, ashtu edhe nxënësve/eve do t'u kërkohet të përdorin maska.
- Dritaret nëpër autobuza do të mbahen të hapura për të qarkulluar ajër i pastër.
- Është kritike që familjarët dhe kujdestarët/et të kontrollojnë fëmijët për simptoma të COVID-19 çdo mëngjes para se ata të vijnë te stacioni i autobuzit. Ky kontroll do të shërbejë si mekanizmi i parë i ekzaminimit për simptoma të COVID-19.
- Shoferët dhe monitoruesit në autobuza do të trajnohen në mënyrën e përshtatshme për të vëzhguar nxënësit/et në hyrje. Nëse ata/ato duket se kanë simptoma dhe nëse një nga prindërit/kujdestarët/et është aty dhe mund t'i marrë në shtëpi, ata nuk do të lejohen të hyjnë në autobuz. Nëse prindi/kujdestari/ja nuk është i/e pranishëm për t'i marrë në shtëpi, nxënësi/ja do të vendoset të paktën dy metra larg nga të tjerët dhe do të drejtohet në infermieri sapo të arrijë në shkollë.
- Çdokush që pret në stacion të autobuzit do të mbajë një maskë, që mbulon hundën dhe gojën gjatë gjithë kohës dhe duhet të ruajë distancën fizike prej 2 metrash.
- Për nxënësit/et do të mundësohet dizinfektant për duart në hyrjen dhe në zbritjen nga autobuzi.
- Të gjithë autobuzat do të dizinfektohen në sipërfaqet që janë prekur më shumë ndërmjet çdo udhëtimi, ndërkohë që do të kryhet edhe një dizinfektim i plotë në përfundim të turnit të mëngjesit dhe në përfundim të turneve të mbasdites.

## Ushqimi

Departamenti i Massachusetts-it për Edukimin Elementar dhe Sekondar (DESE) shpërndau udhëzimet lidhur me veprimet e shërbimeve të ushqimit më 22 Korrik, 2020 dhe vazhdon të lëshojë udhëzime njëkohësisht me Departamentin e Agrikulturës së Shteteve të Bashkuara (USDA) për vitin e ardhshëm shkollor. Departamenti i Ushqimit do të ndjekë standardet e rekomanduara të shëndetit dhe sigurisë dhe rregulla ekzistuese të programve të integritetit gjatë gjithë procesit(eve) të përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit.

Do të mundësohen ushqime të freskëta, me cilësi të lartë ushqyese në shkolla, në një mënyrë që të minimizohet ekspozimi i mundshëm ndaj koronavirusit të ri, duke siguruar mundësinë e përdorimit përmes një shumëllojshmërie modelesh shërbimi, që plotësojnë strukturat aktuale dhe fluide akademike. Ushqimi/përbërësit e menusë do të prodhohen dhe grumbullohen në pikat qendrore të prodhimit në të gjithë qytetin, do të llogariten kur shërbehen sipas kërkesave rregullatore dhe do të ndiqen protokolle të sigurisë gjatë gjithë proceseve: pastrimi i shpeshtë i sipërfaqeve, distanca sociale, maska dhe mburoja fytyre nëse është e nevojshme.

- Nxënësit/et të cilët/cilat janë në sesione në klasë do të marrin mëngjesin në shkollë të paketuar, të shërbyer për konsum në klasë, duke respektuar distancën fizike prej dy metrash midis çdo nxënësi/eje. Një shumëllojshmëri ushqimesh gjatë drekës, të freskëta dhe të para-paketuara, do të jenë për t'u marrë në mencën e shkollës, ku shërbejnë hapësirat në shkolla me kuzhina plotësisht funksionale.
- Nxënësit/et, të cilët/cilat janë në sesione klase në shkolla ku mungon një kuzhinë plotësisht funksionale dhe/ose ka ventilim të papërshtatshëm në zonat e shërbimit të ushqimit do të marrin mëngjesin e paketuar për konsumim në klasa duke ruajtur distancën fizike prej 2 metrash ndërmjet tyre. Një shumëllojshmëri ushqimesh të freskëta dhe të para-paketuara për drekën, do të mundësohet nga zona të shërbimit të ushqimit të lokalizuara në mënyrë strategjike në të gjithë ndërtesën, duke qenë se është e nevoshme të ndiqen standardet e fundit të shëndetit dhe sigurisë.
- Nxënësve/eve, të cilët/cilat nuk do të jenë në ndërtesa shkolle por të grupuar në lokacione alternative në të gjithë qytetin, do t'u mundësohet një shumëllojshmëri mundësish për mëngjes dhe drekë, të paketuara, të shërbyra çdo ditë nga kamionë frigoriferë të shërbimit të ushqimit.
- Nxënësit/et, të cilët/cilat janë parashikuar të mësojnë në distancë do të kenë mundësinë për të marrë ushqime për deri tre ditë, nëpërmjet një tërësish strategjish aksesi: merr-dhe-ik ndërkohë që dalin nga ndërtesa, marrja e tyre nga zona të prodhimit dhe shkolla, dërgesa në shtëpi, si edhe marrje në lagje nga kamionët frigoriferë të shërbimit të ushqimit nëse/siç është e nevojshme.

Të gjitha apo çfarëdo kombinimi i strategjive të mësipërme të ofrimit dhe mundësimit të ushqimit do të zbatohet, siç edhe modelet akademike janë modifikuar, gjatë gjithë vitit shkollor.

## Shëndeti & Siguria

### Përgatitja e Shkollave tona

Departamenti Massachusetts-it të Edukimit Elementar dhe Dytësor (DESE) lëshoi udhëzime për objektet dhe aktivitetet më 22 Korrik, 2020. Distrikti ka përfshirë atë udhëzim në planifikimin tonë dhe ka ndërmarrë një sërë masash të sigurisë në shkollë, për të minimizuar rrezikun për të gjithë anëtarët e komunitetit tonë shkollor, për të siguruar që mund të rikthehemi në mënyrë të sigurt në shkollë ndërkohë që rreziku i COVID-19 mbetet. Së pari, ne realizuam një “Vlerësim të Nevojave të Objektit" shkollë më shkollë. Qëllimi i këtij vlerësimi është të përcaktojë numrin e hapësirave të mësimdhënies dhe klasave në secilën shkollë që mundëson sipërfaqe të përshtatshme në metra katrorë, bazuar në udhëzimet e

miratuara për distancimin social, për të mundësuar që nxënësit/et stafi të mund të ulen në mënyrë të sigurt. Ne jemi në procesin e analizimit të kapacitetevë të sistemit për ajrosjen dhe filtrimin, me qëllim për të siguruar ventilim të përshtatshëm, të sigurt dhe me cilësi të lartë në hapësirat mësimore. Jemi duke identifikuar hapësirë shtesë të zgjeruar për personelin infermieror, për të ndarë nxënësit/et e sëmurë/a nga ata/ato të shëndetshëm, si edhe të kujdesen për nxënësit/et ose personelin në rast se sëmuren gjatë ditës.

## Vlerësimi i Rreziqeve për Cilësinë e Ajrit

Stërpikat nga aparati i frymëmarrjes dhe aerosolet që barten nëpër ajër janë ato që përhapin sëmundjen e COVID-19. Sistemet e Ventilimit të Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar (HVAC) janë krijuar për të qarkulluar ajër të pastër në ndërtesa. Distrikti është duke vlerësuar ndërtesat lidhur me kapacitetet e tyre për të mundësuar shkëmbimin e ajrit të jashtëm në ndërtesa (përmes ventilimit mekanik ose atij natyror). Brenda distriktit, 44% e ndërtesave kanë sisteme ventilimi natyrore, 33% e ndërtesave kanë sisteme mekanike të pjesshme (aftësia për të futur mekanikisht ajrin e jashtëm në ndërtesë pa ndërhyrje mekanike) dhe 23% e ndërtesave janë me sisteme mekanike të plota HVAC. Strategji të tjera, të tilla si pajisjet e jonizimit, filtrat HEPA dhe kuti ventilimi dritaresh janë duke u marrë në konsideratë si mundësi përmirësimi të cilësisë së ajrit dhe filtrimit të brendshëm.

Distrikti po përdor konsulentë për Shëndetin dhe Sigurinë e Mjedisit dhe HVCA për t'a ndihmuar atë në planifikimin dhe përmirësimin e objektit.

## Të qenit gati me Pajisjet e Mbrojtjes Personale (PPE)

WPS ka marrë furnizime për të mundësuar siguri dhe shëndet për nxënësit/et dhe stafin tonë. Pajisjet dhe materialet përfshijnë: maska për fytyrën, mburojat e fytyrës, syze, doreza, veshje të plota, dizinfektant duarsh, sapun, piceta të lagura higjenike, ekranet Pleksiglas janë instaluar në zonat kryesore për të zvogëluar ekspozimin ndaj përhapjes së pikave të mundshme.

- **Maskat janë ndër masat më të rëndësishme për të kufizuar përhapjen e COVID-19.** Të gjithë nxënësit/et (klasat 2-12) dhe personeli duhet të mbajnë një maskë pambuku që mbulon në mënyrë të plotë hundën dhe gojën e tyre. Nxënësit/et më të vegjël nxiten po ashtu të përdorin maska. Përjashtime do të bëhen për nxënësit/et me probleme mjekësore, të sjelljes ose të tjera dhe që nuk janë në gjendje të mbajnë një maskë. Të gjitha moshat duhet të mbajnë një maskë në autobuzin e shkollës. Prindërit do të jenë përgjegjës për sigurimin e maskave të fëmijëve të tyre; shkollat do të kenë në dispozicion maska rezervë.
- **Higjena e duarve është kritike.** Nxënësve/eve dhe personelit u kërkohet të praktikojnë higjenën e duarve (larje ose dizinfektim) pas mbërritjes në shkollë, para ushqyerjes, para se të vendosni dhe të hiqni maska, pas përdorimit të banjës, pas kollitjes ose teshtitjes dhe para largimit nga shkolla.

- **Distanca fizike zvogëlon mjaft rrezikun e transmetimit.** Ndërkohë që COVID-19 transmetohet përmes stërpikave të frymëmarrjes, vendosja e distancës midis vetes dhe të tjerëve zvogëlon rrezikun. Në mjediset e klasës, kur të gjitha palët kanë një maskë, është e domosdoshme një distancë midis nxënësve/eve dhe personelit prej dy metrash.
- **Sedilje të paracaktuara.** Nxënësit/et do të orgnizohen në në grupe/klasa dhe forma të tjera që minimizojnë transmetimin e virusit. Parapërcaktimi i vendeve të uljes është i rëndësishëm sepse krijon në mënyrë efektive grupe edhe më të vogla brenda grupeve që minimizojnë transmetimin. Vendet e caktuara mund të ndihmojnë gjithashtu për gjurmimin e kontaktit.

## Protokolle të Sigurisë në Shkollë

Qëllimi ynë kryesor është një rikthim në shkollë sa më i sigurt i mundshëm. Siç është rekomnaduar nga CDC-ja dhe DESE-ja, po hartohen protokolle të detajuara sigurie.

| Ngjarja | Zona e Ngjarjes | Rezultatet e Testit | Karantina |
|---|---|---|---|
| Individi është simptomatik | Nëse një individ është simptomatik në shtëpi, duhet të qendrojë në shtëpi dhe të bëjë testin. Nëse një nxënës/e shfaq simptoma në autobuz apo në shkollë, duhet të përdorë maskën dhe të respektojë me rigorozitet distancën fizike. Nxënësi/ja do të takohet me infermierin/en dhe do të qendrojë në dhomën mjekësore të pritjes derisa të mund të shkojë në shtëpi. Nuk duhet të shkojë në shtëpi në autobuz.<br><br>Nëse dikush nga stafi paraqet simptoma në shkollë, duhet të gjejnë dikë që të mbulojë punën | Testi i personit rezulton negativ. | Rikthehu në shkollë pas 24 orësh pa simptoma. |
| | | Testi i personit rezulton positiv. | Qendro në shtëpi (përveç rasteve kur merr kujdes shëndetësor), monitoro simptomat, lajmëro shkollën, lajmëro kontaket e afërta, ndihmo shkollën në përpjekjet për gjurmimin e kontakteve dhe përgjigjiu telefonatës nga bordi lokal i shëndetit apo nga Gjurmimi Bashkëpunues në Komunitet i MA-së. Pjesa më e madhe e personave me sëmundje relativisht të buta do të duhet të qendrojnë në vetë-izolim për të paktën 10 ditë dhe deri të paktën 3 ditë të kaluara pa temperaturë dhe simptoma të tjera të përmirësuara. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | e tij/saj, të shkojë në shtëpi dhe të testohet. | Personi nuk është testuar. | Qendro në shtëpi në vetë-izolim për 14 ditë nga momenti i shfaqjes së simptomave. |
| | | | |
| Personi është ekspozuar ndaj personave COVID-19 pozitiv | Nëse një person gjendet në shtëpi kur njoftohet se ka qenë në kontakt të ngushtë me dikë që ka rezultuar pozitiv për COVID-19, ai/ajo duhet të qendrojë në shtëpi dhe të të testohet 4 apo 5 ditë pas ekspozimit të tyre të fundit.<br><br>Nëse një person është në shkollë kur mëson se ka qenë në kontakt të ngushtë me dikë që ka rezultuar pozitiv për COVID-19, ai/ajo duhet të vendosë maskën për pjesën e mbetur të ditës (përfshi edhe nxënësit/et e K-1) dhe të respektojë me rigorozitet distancën fizike. Në fund të ditës, duhet të shkojë në shtëpi dhe jo me autobuz. Duhet të qendrojë në shtëpi dhe të testohet 4 apo 5 ditë pas ekspozimit të tij/saj të fundit. | Testi i personit rezulton negativ. | Rikthehu në shkollë nëse jeni asimptomatik/e ose sapo të keni 24 orë pa simptoma. |
| | | Testi i personit rezulton pozitiv. | Qendro në shtëpi (përveç rasteve kur merr kujdes shëndetësor), monitoro simptomat, lajmëro shkollën, lajmëro kontaket e afërta, ndihmo shkollën në përpjekjet për gjurmimin e kontakteve dhe përgjigjiu telefonatës nga bordi lokal i shëndetit apo nga Gjurmimi Bashkëpunues në Komunitet i MA-së. Pjesa më e madhe e personave me sëmundje relativisht të buta do të duhet të qendrojnë në vetë-izolim për të paktën 10 ditë dhe deri të paktën 3 ditë të kenë kaluar pa temperaturë dhe simptoma të tjera të përmirësuara. |
| | | Personi nuk është testuar. | Qendro në shtëpi në vetë-izolim për 14 ditë nga momenti i ekspozimit. |

## Mbështetje për Nxënësit/et

Shkollat Publike Worcester (WPS) do të vazhdojnë të sigurojnë Nivele Ndërhyrjeje Universale dhe të Ndihmuara për të mbështetur nevojat e Mësimit Social-Emocional (SEL), të të gjithë nxënësve/eve. Kjo

rrit rezistencën e nxënësit/et, krijon dhe përforcon mjedise të mësuari me predispozitë për të reaguar ndaj traumave për të gjithë.

## Nivele të Gamave të Mbështetjes Shtesë

### Mbështetje Niveli 1

*Nxënësit/et kanë nevojë për mbështetje periodike shtesë për të arritur suksesin*

**Ofrues të Mbështetjes**

- Mësues/e Klase
- Konsulente/ë për Përshtatjen
- Psikologë/e Shkolle
- Koordinatorë/e të Paketimit
- Administratorë/e Shkolle
- Trajnerë Didaktikë të Fokusuar
- Asistentë Didaktikë
- Ofrues Shërbimesh të Ngjashme
- Infermierë/e

### Shembuj Mbështetjeje

- Kontrolle SEL
- Kontrolle të Këshilluesit/es së Udhëzimit
- Telefonata Zgjimi
- Kujtesa të Rutinës
- Udhëzime të Diferencuara për Grupe të Vogla
- Plane të të Mësuarit në Distancë
- Mjekësore

### Mbështetje Niveli 2

*Nxënësit/et kanë nevojë për mbështetje shtesë të përditshme për të arritur suksesin*

**Ofrues të Mbështetjes**

- Mësues/e Klase
- Konsulente/ë për Përshtatjen
- Psikologë/e Shkolle
- Koordinatorë/e të Paketimit
- Administratorë/e Shkolle
- Trajnerë Didaktikë të Fokusuar
- Asistentë Didaktikë
- Ofrues Shërbimesh të Ngjashme
- Infermierë/e

### Shembuj Mbështetjeje

- Kontolle të Përditshme
- Udhëzime të Vazhdueshme për Grupe të Vogla
- Ri-Mësimdhënie
- Grupe RTI
- Organizime Ditore/Mbështetje për Shprehi të të Mësuarit
- Mjekësore

# Mbështetje Niveli 3

*Nxënësit/et kanë nevojë për një periudhë mësimdhënieje shtesë të specializuar për të arritur suksesin*

**Ofrues të Mbështetjes**

- Mësues/e Klase
- Mësues/e ESL
- Mësues/e SPED
- Asistentë Didaktikë
- Ofrues të Shërbimeve të Ngjashme
- Specialistë/e të Shëndetit të Sjelljes
- Specialistë/e të Sjelljes
- BCBAs

## Shembuj Mbështetjeje

- Zhvillim i Gjuhës Angleze
- Mësimdhënie Akademike e Specializuar
- Mësimdhënie e Vazhdueshme për Grupe të Vogla
- Mbështetje e Specializuar Social-Emocionale
- Grupe RTI

# Mbështetje Niveli 4

*Nxënësit kanë nevojë për periudha të shumfishta mësimdhënieje shtesë të specializuar për të arritur suksesin*

**Ofrues të Mbështetjes**

- Mësues/e Klase
- Mësues/e ESL
- Mësues/e SPED
- Asistentë Didaktikë
- Ofrues të Shërbimeve të Ngjashme
- Specialistë/e të Shëndetit të Sjelljes
- Specialistë/e të Sjelljes
- BCBAs
- Asistentë Didaktikë

## Shembuj Mbështetjeje

- Zhvillime Intensive të Gjuhës Angleze
- Mësimdhënie Intensive e Specializuar Akademike
- Mbështetje Intensive e Specializuar Social-Emocionale
- Mësimdhënie e Individualizuar në Grupe të Vogla

## Mbështetje Niveli 5

*Nxënësit/et kanë nevojë për mësimdhënie të plotë të specializuar dhe supervizim/mbështetje për të arritur sukses*

**Ofrues Shërbimesh**

- Mësues/e Klase
- Mësues/e
- Mësues/e SPED
- Asistentë Didaktikë
- Ofrues të Shërbimeve të Ngjashme
- Specialistë/e të Shëndetit të Sjelljes
- Specialistë/e të Sjelljes
- BCBAs
- Asistentë Didaktikë
- LPNs
- CNAs

## Shembuj Mbështetjeje

- Zhvillime Intensive të Gjuhës Angleze
- Mësimdhënie Akademike Intensive e Specializuar
- Mësimdhënie e Individualizuar
- Mbështetje Intensive e Specializuar Social-Emocionale
- Mësimdhënie dhe Mbështetje 1:1
- Mbështetje Mjekësore

WPS do të përqendrohet në zhvillimin e komunitetit dhe marrëdhënieve gjatë gjithë ditës duke pasur parasysh tre parime gjithëpërfshirëse: 1. barazi dhe ndërvarësi e sigurisë fizike dhe emocionale; 2. barazi dhe drejtësi racore; dhe 3. kujdesi kolektiv.

Ka një periudhë të strukturuar kohe për zhvillim kulturor ndërkohë që shkollat rihapen. Ditët e shkollës, në distancë apo drejtpërdrejt, do të fillojnë me aktivitete për zhvillimin e komunitetit duke përfshirë qarqet në klasë, takimet e mëngjesit dhe seancat këshilluese.

Shembuj të mbështetjes së përbashkët përfshijnë:

## Niveli I - Universal

- Pritshmëri të përbashkëta për atë që mësuesit/et do të bëjnë për të mbështetur familjet;
- Sondazhe dhe staf në terren për nevoja të vetë-identifikuara të nxënësve/eve dhe familjeve të tyre, të lidhura me teknologjinë, transportin, ushqimin, sigurinë, strehimin ose çështje të shëndetit;
- Të ruhet një komunikim në dy drejtime me familjet si partnere, duke përdorur praktika të përgjegjshme kulturore dhe gjuhësore;

- Shqyrtimi i mbështetjes dhe shërbimeve aktuale, si edhe identifikimi i burimeve shtesë sipas nevojës;
- Sistemi i përcaktuar për të ndjekur përpjekjet e angazhimit të familjes;
- Identifikimi i anëtarëve të stafit të kontrollit;
- Udhëzime për Mësimdhënien Social-Emocionale (SEL) (p.sh., qarqet në klasë/takimet dhe këshillat e mëngjesit)
- Këshilltari/ja për Përshtatjen në Shkollë (SAC)/Psikologu/ja e shkollës organizuan grupet e drekës, orarin zyrtar për nxënësit/et dhe për prindërit;
- Mbështetje Këshillimore Dytësore për zhvillim akademik, karriere dhe social-emocional, dhe së fundmi
- Mbështetje e Gjerë SAC për zhvillimin e nivelit shkollor dhe zbatimin e mbështetjeve dhe ndërhyrjeve universale të sjelljes [p.sh., Zgjidhje Bashkëpunuese e Problemeve, Ndërhyrje Pozitive të Sjelljes dhe Përkrahjes (PBIS), Mentorimi Akademik Bashkëpunues dhe Holistik për Suksesin e Kolegëve (CHAMPS) dhe Praktikat Restauruese].

## Niveli II dhe III- Ndërhyrje të targetuara

Shumë shkolla kanë Koordinatorë *Wraparound*, të cilët ndihmojnë familjet të aksesojnë burimet e komunitetit. Gjithashtu, dy anëtarë stafi nga Zyra e të Mësuarit Social-Emocional janë përcaktuar në mënyrë ekskluzive të ndihmojnë familjet të cilat janë të pastreha. Ky staf do të ofrojë punë në terren dhe menaxhim rasti për të ndihmuar familjet nëpër strehëza apo ato të cilat kanë nevojë për mbështetje për të siguruar një banim të qendrueshëm.

Për ata nxënës/e, të cilat/cilët kërkojnë një mbështetje shtesë, Konsulentët/et e Përshtatjes në Shkollë, Specialistë të Shëndetit të Sjelljes, Psikologë Shkolle, Këshillues/e Sekondarë/e dhe Koordinatorë *Wraparound* do të mundësojnë dhe ofrojnë ndërhyrje më shumë specifike për nxënësit/et, duke përfshirë:

- Kontrolle individuale
- Grupe të vogla për t'u përqendraur në aspekte specifike të nevojave
- Plane të Individualizuar të Sjelljes
- Punë në terren me prindërit dhe
- Koordinim i burimeve të Komunitetit.

## Suport për të Mësuarit Social-Emocional për Nxënësit/et me Aftësi të Kufizuara (SWD-ë)

SWD-të dhe familjet e tyre kanë qasje në "*Google SEL Classroom*: *2020 Behavior Interventions & Supports*" (Klasa Google SEL: Mbështetje dhe Ndërhyrje të Sjelljes 2002). Të përfshira janë edhe burimet në vijim nën punën në klasë:

- Aktivitete Sociale në Shtëpi
- Aktivitete Krijuese
- Mjete të Përballjes së Stresit të Bëra në Shtëpi
- Informacion Kurrikular Superfleks: Përshkrim Personazhi, Lexime me Zë Superfleks

- Përqendrimi te vetja (*Mindfulness)*/ Aktivitete Yoge dhe
- Materiale Virtuale të Leximit me Zë

**Roli i Specialistit/es së Sjelljes për Edukimin e Veçantë**:
Specialistët/et e Sjelljes luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e nxënësve/eve me aftësi të kufizuara social-emocionale, si edhe shërbejnë si një urë ndërmjet shkollës, familjeve dhe komunitetit. Në vijim renditen disa nga përgjegjësitë e specialistit/es së sjelljes:

- Mundësimi i mbështetjes këshillimore 1:1 për nxënësit/et në fushat e vetë-advokacisë, të identifikimit të përshtatshëm të emocioneve dhe praktikim të aftësive të përballjes së stresit;
- Ofrimi i këshillimit në grup për të promovuar kompetenca të të mësuarit social-emocional (ndërgjegjësim social, vetë-ndërgjegjësim, vetë-menaxhim, aftësi marrëdhëniesh, vendim-marrje e ndërgjegjshme) duke përdorur përqasje të bazuara në fakte, të tilla si Terapi të Sjelljes Konjitive (CBT), Terapi Dialektike të Sjelljes (DBT), Terapi për Trauma e Përqendruar në Sjelljen Konjitive (TF-CBT), si edhe *mindfulness*/ yoga;
- Këshillime me anëtarë të stafit dhe adminsitratës për të mbështetur sa më mirë funksionimin dhe mirëqenien e nxënësit/es;
- Plane ndërhyrjeje për zhvillimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të progresit të sjelljes (BIP-e) për të mundësuar një zbatim efektiv në të gjitha drejtimet;
- Menaxhime rasti duke përfshirë një komunikim të vahzdueshëm me ofrues të jashtëm [p,sh., terapistë ambulantë, Mjekë të Kujdesit Parësor (PCP-ë), psikiatër, punonjës rasti të Departmentit të Fëmijëve dhe Familjeve (DCF), punonjës të Departmentit të Shërbimeve për të Rinjtë (DYS), punonjës/e të shtëpive në grup, ofrues për strehëzat e të pastrehëve];
- Sensibilizim i familjeve për të mundësuar komunikim të qartë dhe të qendrueshëm ndërmjet stafit të shkollës, kujdestarëve/eve dhe çfarëdo pale tjetër të interesuar në mbështetjen e mirëqenies social-emocionale dhe suksesit akademik të nxënësit/et dhe
- Sigurimi i informacionit në burime të ndryshme komuniteti (p.sh., akses në bankat e ushqimit, ndihma e karburantit, strehëzat, kujdesi për pas shkollës/kujdesi ditor)

**Roli I Analistit/es së Çertifikuar të Sjelljes (BCBA):**
BCBA-ja punon në bashkëpunim me Supervizorin/en për Autizmin të Distriktit dhe/ose me Drejtuesin/en e Departmentit, Drejtorin/Drejtoreshën, mësues/e të edukimit të veçantë dhe atij të rregullt, si edhe me stafin mbështetës për t'u siguruar se shpërndarja e shërbimeve të IEP-së, në fushën e analizës së sjelljes së aplikuar, po mundësohen me besnikëri në përputhje me programet e individualizuara të edukimit. BCBA-ja do të mundësojë gjithashtu trajnim dhe mbështetje për stafin e edukimit të veçantë, familjet dhe paraprofesionistët ABA, për të ndihmuar në mbështetjen e nxënësve/eve me autizëm dhe me aftësi të tjera të kufizuara emocionale/zhvillimore. Shërbimet do të bazohen në parimet e analizës së sjelljes së aplikuar përfshi edhe modifikimin e variablave mjedisorë, procedura të reduktimit të sjelljes dhe mësimdhënie sistematike (p.sh., të mësuarit diskret "*discrete trial teaching*", udhëzime të rastësishme "*incidental instruction*") për të mësuar shprehi të reja dhe/ose adaptive, si edhe ruajtjen dhe përgjithvsimin e shprehive). Në vijim përshkruhen disa nga përgjegjësitë e BCBA-ve:
- Mundësim i mbështetjes konsultuese në Analizën e Sjelljes së Aplikuar (ABA) të diktuar nga Programi i Edukimit Individual të nxënësit/es (IEP);
- Marrja pjesë në takime të skuadrave për të identifikuar nevojat e nxënësve/eve dhe për të zhvilluar shërbime që plotësojnë këto nevoja;
- Bashkëpunimi me mësuesit/et për të gjithë planin e sjelljes (të tillë si, menaxhimi i klasave dhe ndërhyrja, strategji) në programe të specializuara dhe klasa të nën-ndara;
- Sipas rastit, të zhvillojë Plane Sjellje të Ndërhyrjes/Mbështetjes në bashkëpunim me stafin (p.sh., vëzhgime në klasa, mundësimi i mjeteve për mbledhje të dhënash)**;**
- Disponueshmëri për t'u konsultuar me arsimin e përgjithshëm për nxënës/e të tjerë me aftësi të kufizuara (SWD) për planifikimin e sjelljes (d.m.th., protokollin e distriktit për ekzaminim);

- Krijimi i planeve të ndërhyrjes së sjelljes bazuar në mbledhje të dhënash dhe/ose vlerësime në bashkëpunim me mësues/e;
- Mbledhja e të dhënave të vazhdueshme duke përdorur skeda teknike specifike për nxënësit/et, analizim të dhënash, plotësimi i raporteve të progresit të nxënësit/es për qëllime sociale/të sjelljes, në bashkëpunim me mësues/e dhe anëtarë të tjerë stafi;
- Realizimi i Vlerësimeve ABA dhe/ose të Sjelljes siç kërkohet, nëpërmjet procesit të SKUADRËS dhe përdorimi i të dhënave të marra nga rezultatet e vlerësimeve, për të marrë vendime të informuara dhe për t'i dhënë rekomandime Skuadrës së IEP-së;
- Mbështetja e zhvillimit dhe zbatimit të grupeve të shprehive sociale të qendrueshme, në bashkëpunim me mësues të tjerë dhe me anëtarë të tjerë stafi, si pjesë e programeve ABA;
- Marrje pjesë në takime klinike me prindërit, mësuesit/et dhe anëtarë të tjerë stafi për të shqyrtuar progresin dhe të dhëna të tjera të nxënësit/es;
- Mundësimi i koordinimit të rastit ndërmjet shkollës dhe agjencive të jashtme për të siguruar bashkëpunim dhe qendrueshmëri në praktiak të ndryshme;
- Mundësimi i trajnimeve të specializuara për analizën e sjelljes së aplikuar stafit të shkollës dhe familjeve, si edhe
- Marrje pjesë në takimet e Komunitetit të të Mësuarit Profesional (PLC) dhe bashkëpunim me administratorët/et e ndërtesës dhe me stafin mësimdhënës, për të plotësuar nevojat e të gjithë nxënësve/eve.

**Tryeza të Rrumbullakëta me Prindër**:

Prindërit e SWD-ve do të kenë mundësi për të marrë pjesë në Tryeza të Rrumbullakëta për t'i mbështetur ata në të ndihmuarin e fëmijës së tyre, përfshi:

- *Kujdesi për një Fëmijë apo Adoleshent/e të Ekspozuar ndaj Traumës:* Qëllimi i kësaj Tryeze të Rrumbullakëta është të rrisë nivelin e të kuptuarit të kujdestarëve/eve të faktorëve kryesorë që shoqërohen me sfida gajtë kujdesit të një fëmije që ka kaluar trauma. Strategjitë specifike përqendrohen në adresimin e nevojave dhe kompetencve të të mësuarit social-emocional të fëmijëve/adoleshentëve/eve të prekur nga trauma.
- *Mësimi i Rastësishëm (Incidental Teaching)*: Ky prezantim mbulon mënyrën sesi të krijohet dhe të përfitohet nga momente reale me fëmijën tuaj në shtëpi dhe gjatë një dite të zakonshme. Fokusi është në lojën dhe mundësitë sociale. Do të merren gjithashtu parasysh pyetje nga prindërit lidhur me shqetësime mbi këtë formë të mësuari në shtëpi.
- *Përfshirje Akademike në Distancë*: Ky prezantim mbulon strategji, mbështetje dhe mjete social-emocionale për të mbështetur fëmijën tuaj gjatë procesit të të mësuarit në distancë. Fokusi i prezantimit është të ofrojë sugjerime për prindërit lidhur me mbështetjen e procesit të të mësuarit të fëmijës/adoleshentit në një mjedis të largët dhe hibrid.

| **Mbështetja për të Mësuarin Social-Emocional për Nxënës/e me Aftësi të Kufizuara/ 504 Plane** | | |
|---|---|---|
| **Në Distancë** | **Hibrid** | **I Drejtpërdrejtë** |

| | | |
|---|---|---|
| • Komunikim i vazhdueshëm mes prindërve dhe stafit të sjelljes, i mundësuar në distancë<br>• Staf i disponueshëm gjatë orarit zyrtar<br>• Grupe të shpehive sociale për t'u mundësuar në distancë dhe duke përfshirë vetë-ndërgjegjësim, vetë-menaxhim, ndërgjegjësim social, shprehi të marrëdhënieve dhe vendim-marrje të përgjegjshme<br>• Aktivitete SEL të postuara në Klasat Google<br>• Shërbime për IEP-të do të ofrohen nëpërmjet mundësive në distancë<br>• Bashkëpunim i vashdueshëm me ofrues shërbimesh të brendshëm dhe të jashtëm nëpërmjet metodologjive të ndryshme | • Kontroll/komunikim i vazhdueshëm i prindërve me stafin e sjelljes, të mundësuar në distancë<br>• Staf i disponueshëm gjatë orarit zyrtar<br>• Kombinim i grupeve të shprehive sociale në distancë dhe të drejtpërdrejtë, duke përfshirë vetë-ndëgjegjësim, vetë-menaxhim, ndërgjegjësim social, shprehi të marrëdhënieve dhe vendim-marrje e përgjegjshme<br>• Aktivitete SEL për t'u realizuar personalisht dhe nëpërmjet aktiviteteve të postuara në Klasat Google<br>• Shërbime për IEP-të, të mundësuara nëpërmjet një kombinimi të mundësive në distancë dhe atyre të drejtpërdrejta<br>• Bashkëpunim i vashdueshëm me ofrues shërbimesh të brendshëm dhe të jashtëm nëpërmjet metodologjive të ndryshme | • Kontroll/komunikim i vazhdueshëm i prindërve me stafin e sjelljes, të mundësuar në distancë<br>• Staf i disponueshëm gjatë orarit zyrtar<br>• Grupe të drejtpërrejta të shprehive sociale, duke përfshirë vetë-ndëgjegjësim, vetë-menaxhim, ndërgjegjësim social, shprehi të marrëdhënieve dhe vendim-marrje e përgjegjshme<br>• Mundësi dhe aktivitete SEL të përfshira në të mësuarin e drejtpërdrejtë<br>• Shërbime të IEP-së të mundësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë<br>• Bashkëpunim i vazhdueshëm me ofrues të brendshëm dhe të jashtëm shërbimesh nëpërmjet metodologjive të ndryshme |

## Mbështetja për Familjet/Kujdestarët/et

Çdo shkollë ka një Këshilltar/e për Përshtatjen në Shkollë (SAC) dhe një Psikolog Shkolle të përcaktuar. Gjithashtu, shkollat fillore dhe të mesme kanë Këshilltarë/e Orientimi dhe shumë shkolla kanë Koordinatorë *Wraparound*. Lutemi, të kontaktoni edhe me administratorin/en e shkollës së fëmijës suaj, nëse keni nevojë për kontaktet e stafit.

Faqja e internetit të WPS-së ofron lloje të ndryshme mbështetjesh për familjet dhe kujdestarët/et. Lutemi të vizitoni Special Education Family/ Caregiver Extended Learning Website (Faqja në Internet për të Mësuarin e Zgjeruar të Edukimit të Veçantë për Familjen/Kujdestarët/et). Aty përfshihen një shumllojshmëri burimesh në çështje që përfshijnë informacion akademik, social-emocional dhe të sjelljes, si edhe terapi për autizëm dhe muzikë.

- Academic Resources (Burime Akademike)
- Autism (Autizëm)
- Behavioral/Social Emotional Resources (Burime të Sjelljes/Social-Emocionale)
- Additional Resources (Burime të tjera Shtesë)

## Të Mësuarit Dixhital dhe Mbështetja/Trajnimi për IT për Familjet

Një sondazh i kryer gjatë vjeshtës së 2019-ës tregoi se 60% e familjeve dëshironin të mësonin më shumë lidhur me mjetet dhe aplikacionet dixhitale, që fëmijët e tyre përdornin në shkollë, me qëllim për t'a pasur të mundur t'i ndihmojnë ata me detyrat e shtëpisë. Ne jemi duke e zgjeruar mbështetjen që u ofrojmë familjeve dhe jemi duke punuar me stafin, familjet, nxënësit/et dhe organizata të komunitetit për të krijuar një qendër burimesh të rinovuara teknologjike, që është më e organizuar dhe më e thjeshtë për t'u kuptuar nga masa. Kjo do të ekzistojë në disa gjuhë. Përveç kësaj, do të organizojmë edhe uebinare të drejtpërdrejta teknologjikë me familjet në të gjithë distriktin.

- Akademia e Kujdesit Teknologjik e WPS-së
- Uebinare të organizuar drejtpërdrejt me familjet mbi mbështetjen teknologjike
- Koordinim me partneret e komunitetit
- Mbështetje direkte dixhitale për të ndihmuar me kërkimin dhe aplikacionet e të mësuarit
- Mbështetje IT: Nëse keni probleme elektronike me Chromebook-un tuaj apo probleme me hyrjen në adresën tuaj, lutemi ose të kontaktoni shkollën tuaj për një rinovim të fjalëkalimit, ose telefononi në 508-799-3312 për ndihmë.

## Persona që Mësojnë Gjuhën Angleze

Në do të gjejmë mënyra për të vazhduar punën me Këshillin Këshillimor të Prindërve të Fëmijëve që Mësojnë Anglisht (*English Learners Parent Advisory Council* ELPAC) në distancë për të vlerësuar nevojat e familjeve tona.

Ne do të vazhdojmë të krijojmë video dhe t'i postojmë ato në platformat e medias tonë sociale, si edhe ndajmë me drejtuesit/et dhe mësuesit/et tona ESL/DL/TBE: Disa shembuj të videove të mëparshme përfshijnë:

- School Routines at Home (Rutina Shkolle në Shtëpi)
- Parents as Natural Teachers (Prindërit si Mësues/e Natyralë/e)
- Homeëork (Detyra Shtëpie)
- The Superpoëer of Being Bilingual (Superfuqia e të Diturit Dy Gjyhë)

Ne jemi gjithashtu duke planifikuar uebinarë që mbulojnë çështje që kanë të bëjnë me shkrim-leximin teknologjik dhe mbështetjen e të mësuarit nga shtëpia. Ide për tema përfshijnë:

- La aventura de leer: Cómo fomentar el amor por la lectura en dos idiomas

- Të Rënit në Dashuri me të Lexuarin në Dy Gjuhë
- Comunicación afectiva y efectiva - Acércate a tu hijo enseñándole técnicas de estudio
- Komunikimi Efektiv dhe Lidhja si Familje: Të Krijosh një Lidhje me Fëmijën Tënd Nëpërmjet Zakoneve të Studimit
- Të Shfrytëzohet Gjuha e Shtëpisë
- Takime Zoom dhe Google 101
- Hapja e një adrese e-maili në google
- Të kutpuarit e platformave të të mësuarit virtual (klasa *Google*, *Clever* dhe aplikacione)

Ne do të vazhdojmë të punojmë me organizata në komunitet, që punojnë me familjet emigrante virtualisht për t'i mbajtur ata të informuar dhe për të shpërndarë burime.

WPS-ja do të mundësojë akses për të gjithë stafin ndaj Linjave të Gjuhës për komunikim multigjuhësor. Gjithashtu, një LINJË NDIHME (*HELP LINE*) do të ngrihet për familjet tona EL, për të telefonuar lidhur me pyetje të përgjithshme apo shqetësime.

## Departamenti i Mbështetjes për Edukimin e Veçantë për Tryeza të Rrumbullakëta me Familje dhe Prindër:

- Skuadra të lidershipit për edukimin e veçantë do të vazhdojnë të ruajnë partneritetin me Këshillin e Prindërve për Edukimin e Veçantë (SPED PAC) në distancë për të mbështetur nevojat e familjeve tona;
- Të theksuarit e vazhdueshëm i trajnimeve eksplicite për nxënësit/et, të cilët/cilat kanë aftësi të kufizuara të lidhura me gjuhën, përfshi edhe Disleksi;
- BCBA-të e Distriktit do të vazhdojnë të ofrojnë takime klinike me prindër dhe ofrues shërbimesh për të monitoruar progresin e nxënësit/es dhe për të shqyrtuar të dhëna për të marrë vendime objektive lidhur me programimin. Këto takime do të ofrohen të paktën në çdo tremujor dhe më shpesh në funksion të BCBA-së, ose në bazë të kërkesës nga prindi;
- Specialistë të Sjelljes së Distriktit SPED dhe BCBA-të do të vazhdojnë të ofrojnë tryeza të rrumbullakëta të specializuara me prindërit, në sinkron dhe në asinkron. Këto tryeza të rrumbullakëta të specializuara përfshijnë:

  *Kujdesi për një Fëmijë apo një Adoleshent të Ekspozuar ndaj një Traume:* Qëllimi është të rritet niveli i të kuptuarit të kujdestarëve i faktorëve kryesorë që çojnë në sfida gjatë kujdesit për fëmijët që përjetojnë trauma. Strategji specifike përqendrohen në adresimin e nevojave dhe aftësive të të mësuarit social-emocional të fëmiëjve/adoleshentëve që kanë përjetuar trauma.

  Të Mësuarit Rastësor (*Incidental Teaching)*: Ky prezantim mbulon se si të krijohen dhe të përfitohet nga momente mësimdhënieje më fëmijën tuaj në shtëpi dhe gjatë një dite të zakonshme. Vëmendja përqendrohet te loja dhe te mundësitë sociale. Do të evidentohen pyetje të bëra nga prindërit lidhur me shqetësime mbi këtë metodë në shtëpi.

  *Angazhim Akademik në Distancë*: Ky prezantim mbulon strategji, mbështetje dhe mjete social-emocionale për të mbështetur fëmijën tuaj gjatë të mësuarit në distanë. Fokusi i prezantimit është të ofrojë sugjerime për prindërit lidhur me mbështetjen e fëmijës/adoleshentit në procesin e të mësuarit në distancë dhe të mjediseve hibride.

## Mbështetje në Komunitet & Pas-shkollore

Programe pas-shkollorë do të ofrohen në formate të kufizuar ndërkohë që rikthehmi në shkollë këtë vjeshtë. Propozimet e planifikuara përfshijnë si më poshtë për modelin hibrid dhe atë të plotë në distancë:

- Shekulli i 21-të për Shkollën e Mesme Burncoat dhe për atë Fillore Vernon Hill;
- E Shtuna DESE dhe programe të Pushimeve Shkollore për nxënës/e në rrezik të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazet;
- Sesione shtesë ndihme pas shkollës (shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet);
- Referime për këshillime pas shkollore nëpërmjet agjencive komunitare dhe
- Skuadra për Nismën Mendja ka Rëndësi (*Shine Initiative MindMatters Teams*) në lokacione sekondare dhe shkolla.

WPS është duke planifikuar momentalisht me institucione kulturore lokale për t'u ofruar nxënësve/eve të të gjitha klasave mundësi.  Më shumë infomacion do të ndahet në javët në vijim.

## Komunikimi

Në vitin që na pret është shumë e rëndësishme që ne të kujdesemi për njëri-tjetrin duke zhvilluar një ndjesi të një qëllimi të përbashkët, krijimit të marrëdhënieve të forta dhe përforcimit të aftësive sociale dhe emocionale që ne përdorim për të mbështetur njëri-tjetrin, si edhe të përballojmë sfidat së bashku. Koncepti i kujdesit kolektiv është përfshirës i praktikave të kujdesit për veten, por shkon edhe më tej, duke na kërkuar të tregojmë dhembsuri në mënyrë pro-aktive njëri për tjetrin.

Shkollat Publike Worcester (WPS) do të vazhdojnë të komunikojnë me nxënësit/et, prindërit/kujdestarët/et, stafin dhe anëtarë të komunitetit nëpërmjet e-mailit, mesazheve telefonike *Connect ED*, telefonatave, postimeve në faqen e internetit të WPS-së worcesterschools.org, postës dhe medias sociale.

WPS-ja do të vazhdojë të përkthejë të gjithë dokumentat e rëndësishëm në shtatë gjuhë: Spanjisht, Portugalisht, Tvi, Nepalisht, Shqip, Arabik dhe Vietnamisht. Po ashtu, do të vazhdojë të mundësojë shërbime përkthimi në këto gjuhë për forumet komunitare të distriktit, si edhe për aktivitetet në shkolla. WPS-ja mundëson shërbime përkthimi duke përdorur një Linjë Gjuhe (*LanguageLine*) për gjuhë të tjera shtesë.

Kemi edhe një adresë specifike emaili covid19@worcesterschools.net për pyetje lidhur me Covid-19 nga stafi, nxënësit/et, familjet dhe anëtarët e komunitetit.

## Kurrikula

Stafi i Shkollave Publike Worcester do të përdorë standardet e përmbajtjes dhe praktikës së MA, platformës kurrikulare në internet (Atlas) të Shkollave Publike Worcester, dhe burimet, materialet dhe dokumentet udhëzuese të ndara në Google classroom për të planifikuar dhe krijuar leksione që përfshijnë kurrikulën, pedagogjinë dhe teknologjinë. Ndërlidhësit e kurrikulave të distriktit, trainerët e përmbajtjes dhe trainerët e teknologjisë do të jenë të disponueshëm për ndihmë për kurrikulën dhe teknologjinë gjatë orarit të punës, komuniteteve profesionale të të mësuarit dhe seminareve të synuara, webinareve dhe trajnimeve.

Për shkak të zhvendosjes në mësimin në distancë dhe zvogëlimit të kohës ballë për ballë me nxënësit, sekuenca e disa standardeve të përmbajtjes së nivelit të notave është ndikuar. Mësuesit do të fillojnë me standardet aktuale të nivelit të klasës. Mësimet do të kenë shtim në përmbajteje sipas nevojës bazuar në të dhënat e vlerësimit.

Shkollat Publike Worcester angazhohen për disa modele të përvojave të mësimit përfshirë:

- **Mbështeni zgjedhjen e nxënësit/ agjensisë së nxënësve.** Hartoni mësime dhe aktivitete që të përfshijnë opsione për nxënësit, për shembull, një menu zgjedhjesh, një larmi materialesh dhe burimesh për të zgjedhur, gjatësi të ndryshme të aktiviteteve, dhe ndërhyrje në stile dhe modalitete të ndryshme të të mësuarit, përfshirë kornizën e Dizajnit Universal për të Mësuarin.
- **Diferencim**. Vazhdimisht konsideroni procesin, produktin, hapin dhe burimet në mësime dhe aktivitete për të siguruar që në një farë mënyre të gjithë nxënësit të marrin pjesë, përfshirë bashkë-mësimdhënies dhe modelet përfshirëse.
- **Përqendrohuni në zhytjet më të thella në mësime përmes angazhimit.** Sfidoni nxënësit në mënyra të reja. Tani është koha për të provuar atë gjë që gjithmonë kemi dashur të bëjmë që ne e dimë se do të emocionojnë nxënësit dhe do të sjellë gëzim në mësim.
- **Bashkëpunim**. Ofroni një mori burimesh për të ndihmuar nxënësit.
- **Komunikim, komunikim, komunikim**. Me nxënësit dhe familjet - përfshirë përmes postës elektronike, Google docs, përmes Google Classroom, mesazhet dhe aplikacionet nga distrikti.
- **Feedback nga nxënësi**. Komunikimi me nxënësit dhe familjet përfshin feedback të drejtuara në kohë dhe veprim në mësimin e nxënësve.

## Mësimi

### Mësimdhënie dhe Mësim me Cilësi të Lartë

Mësimdhënia dhe Mësimi i Cilësisë së Lartë është i pasur në përmbajtje, me nxënësin në qëndër, i matshëm dhe ekziston në një kulturë me pritshmëri të larta për të gjithë nxënësit PreK - 12. Klasat mësimore me cilësi të lartë janë të ndjeshme ndaj nevojave, interesave, pikave të forta, aftësive, mënyrave të kontributit, prejardhjes sociale / kulturore të nxënësve dhe adresojnë tre elemente thelbësore: organizimi i klasës; hartimin dhe shpërndarjen mësimore dhe zotimin e nxënësve për të mësuar.

Mësuesit, nxënësit, dhe familjet bashkëpunojnë së bashku në çdo element esencial për të maksimalizuar mësimin dhe suksesin e nxënësit.

### Organizimi I Ambjentit Mësimor

| Mësuesit | Nxënësit | Familjet |
|---|---|---|
| Vendosni dhe ushqeni një ndjenjë të bashkësisë brenda secilës klasë<br>● Ofroni mundësi për nxënësit dhe stafin për të krijuar marrëdhënie<br>● Ofroni mundësi për nxënësit që të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin<br>● Ofroni mundësi për nxënësit që të ndajnë mësimin, eksperiencat, ndjenjat, dhe nevojat e tyre<br>● Angazhohuni në komunikim të dyanshëm me familjet / kujdestarët (duke përdorur Linjën e Gjuhës dhe burimet e tjera të distriktit për të komunikuar në gjuhët amtare të familjeve)<br><br>Komunikoni objektivat e qarta të mësimit dhe pritshmëritë e performancës në mjedisin<br>● Postojnë detyra përpara orarit të | Të jeni në kohë për të gjitha klasat dhe merrin pjesë aktive në seancat e klasës virtuale<br>● Ndizni videon, kur është e mundur<br>● Jeni të vëmendshëm<br>● Shtoni në diskutime dhe biseda<br>● Përgjigjuni pyetjeve të bashkëmoshatarëve<br>● Ndani mësimin, eksperiencat, ndjenjat, dhe nevojat<br><br>Jeni të vetëdijshëm për rezultatet e mësimit dhe qëllimin e mësimit për ditën si dhe të përfundojnë të gjitha detyrat e caktuara<br>● Përdorni mjetet teknologjike për të ndihmuar mësimin<br>● Përdorni mjete organizimi siç janë Google Calendar, libra/ planifikues, | Shikoni orarin, takohuni me mësuesit dhe forconi normat, dhe pritshmëritë e pjesëmarrjes<br><br>Shikoni programin javor dhe jepni udhëzime dhe rikujtime për pjesëmarrjen dhe detyrat e kërkuara<br><br>Përgatisni vendin për mësim me materialet dhe oraret e aksesueshme lehtësisht.<br><br>Aksesoni trajnimin e teknologjisë së distriktit dhe përpiquni të mësoni mjete të reja teknologjike me fëmijën tuaj<br><br>Flisni rregullisht me fëmijën tuaj për atë që kanë mësuar<br><br>Rregullisht angazhohuni në |

| | | |
|---|---|---|
| klasës<br><br>● Mësoni nxënësit të përdorin mjete organizimi, ndihmë vizuale, dhe akomodime<br><br>Orkestroni mundësi mësimdhënie që adresojnë disa stile mësimi, për të siguruar angazhim të lartë nga nxënësit<br><br>Ofroni një larmi aktivitetesh mësimore angazhuese, me interes të lartë | etj. për të manaxhuar kohën dhe detyrat<br><br>● Pyesni mësuesit tuaj dhe stafin e shkollës për ndihmë sipas nevojës, bëni pyetje dhe komunikoni nevojat tuaja kur ato shfaqen<br><br>● Punoni në grupe të vogla dhe të mëdha, dhe shkëmbeni ide/ mësime në disa mënyra | komunikim me shkollën tuaj për të aksesuar mbështetjen dhe mjetet e nevojshme për të dhënë informacion në gjuhën tuaj amtare. |

## Hartimi dhe Dhënia e Mësimit (Instructional Design and Delivery)

| Mësuesit | Nxënësit | Familjet |
|---|---|---|
| Përdorni kohën në mënyrë efektive kur jepni udhëzime të drejtpërdrejta dhe planifikim për punën e pavarur të studentëve.<br><br>Përdorni vlerësime / vëzhgime informale dhe formale për të identifikuar nevojat e mësimit të të gjithë nxënësve dhe të përcaktoni se si t'i plotësoni më mirë nevojat e tyre.<br><br>● Vlerësoni nxënësit vazhdimisht dhe ndani rezultatet me nxënësit dhe familjet. (STAR, Edcite)<br><br>● Ofroni feedback në kohë për detyrat e përfunduara nga nxënësit. | Përfundoni të gjitha detyrat e caktuar në kohën e duhur dhe postojini në Google Classroom dhe SeeSaw<br><br>Merrni pjesë në të gjitha detyrat dhe krijoni objektiva për përmirësim<br><br>Shqyrtoni rezultatet e vlerësimeve dhe vendosni objektiva për përmirësim<br><br>Dorëzoni detyrat në kohën e duhur dhe reflektoni për notat dhe feedback nga mësuesit | Monitoroni kohën në detyra, ofroni pushime dhe kujtesë për t'u rikthyer detyrave sipas nevojës<br><br>Shqtyrtoni të gjithë rezultatet e vlerësimeve të dhëna nga mësuesit dhe diskutoni me nxënësit.<br><br>Rishikoni rregullisht feedbak-un e mësuesve për detyrat dhe ndihmoni nxënësit të jenë të azhurnuar me detyrat e shkollës |

## Zotërimi i Mësimit nga Nxënësit

| Mësuesit | Nxënësit | Familjet |
|---|---|---|
| Ofroni mundësi për të festuar arritjet dhe ftoni prindërit të marrin pjesë<br><br>Monitoroni rregullisht progresin e nxënësve përmes mjeteve të shumta dhe | Përdorni kohën e kontrolli të mësuesit dhe seancat ndihmëse shtesë kur ata kanë nevojë për ndihmë të çdo lloji<br><br>Kontaktoni këshilltarët udhëzues, | Komunikoni me stafin e shkollës kur fëmija juaj është i hutuar dhe kërkon ndihmë nga stafi |

| | | |
|---|---|---|
| rregullisht jepni feedback për nxënësit në lidhje me përparimin dhe qëllimet e tyre individuale.<br><br>Artikuloni të dhëna personale dhe objektiva për suksesin akademik<br><br>Ofroni kujtesa të rregullta për nxënësit për herët e kontrollit, seancat shtesë të ndihmës dhe mundësive të tjera të ndihmës shkollore dhe komunitare | këshilltarët rregullues, specialistët e sjelljes dhe koordinatorët e shërbimeve mbështjelljellëse dhe stafin tjetër mbështetës për të advokuar për nevoja akademike, sociale dhe emocionale.<br><br>Mbani shënim detyrat e përfunduara dhe progresin | Mbani një listë të orarit të stafit mbështetës dhe orëve të takimit për tu siguruar që nxënësit marrin pjesë.<br><br>Merrni pjesë në festimet virtuale të klasës.<br><br>Shqyrtoni progresin e nxënësve me stafin e shkollës për tu siguruar që fëmija juaj po bën progresin e duhur. |

## Pritshmëritë nga Drejtorët dhe Mësuesit

Për të siguruar Mësimdhënie dhe Mësim me Cilësi të Lartë, drejtorët dhe mësuesit do të kryejnë përgjegjësitë e mëposhtme:

| **Drejtorët do të...** | **Mësuesit do të**... |
|---|---|
| ● Caktojnë stafin për të mbështetur dhe monitoruar nxënësit gjatë ditëve të mësimit në distancë përmes kontrolleve ditore dhe seancave të ndihmës<br>● Monitorojnë mungesat e nxënësve, dhe mbështetin familjet në mbajtjen e pjesëmarrjes së mirë gjatë mësimit në distancë.<br>● Koordinojnë mbështetjen e familjes<br>● Koordinojnë shërbimet mbështetëse për stafin dhe nxënësit<br>● Ofrojnë siguri që objektivat e IEP janë implementuar me përpikmëri<br>● Monitorojnë google classrooms për të garantuar që të gjitha mësimet video, ushtrimet, dhe detyrat janë postuar dhe gati për tu përdorur nga nxënësit.<br>● Monitorojnë hyrjen dhe përparimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe programeve të mësimit on-line (ie. LEXIA, ST MATH, ALEKS)<br>● Mbështesin / Lehtësojnë mbledhjet e | ● Mbajnë rekorde të sakta të mungesave, monitorojnë mungesat e nxënësve dhe raportojnë shqetësimet për pjesëmarrjen e nxënësve.<br>● Krijojnë një Google Classroom ose Seesaw të organizuar mirë (në varësi të nivelit të klasës) për nxënësit që ti aksesojnë çdo ditë; çdo ditë mësimi në distancë do të përqendrohet në ELA, Matematikë, ose Shkencë.<br>● Postojnë video të leksioneve, ushtrimeve, dhe detyrave për nxënësit që ti përfundojnë gjatë kohës asinkronike.<br>● Përgatisin mini leksione, në çdo fushë të përmbajtjen në përputhje me standartet.<br>● Sigurohen që puna e caktuar është në përputhje me edukimin special dhe planet ELL, dhe të bashkëpunojë me arsimin special dhe mësuesit e ELL në planifikimin dhe zbatimin e mësimeve nga distanca.<br>● Dorëzojnë udhëzime të krijuara posaçërisht bazuar në IEP-të e nxënësve<br>● Plotësojnë raportet e progresit të IEP për të dokumentuar progresin e nxënësve me aftësi të kufizuara drejt arritjes së objektivit të IEP.<br>● Japin nxënësve rutinën / orarin e pritshëm të ditës gjatë mësimit në distancë. Koha për detyrat duhet të jetë e lidhur me moshën e tyre dhe kohën e |

| | |
|---|---|
| stafit dhe komuniteteve profesionale të të mësuarit | rekomanduar në pajisje.<br>● Monitoroni hyrjen e nxënësve dhe përparimin në programet e mësimit on-line (ie. LEXIA, ST MATH, ALEKS)<br>● Mbajnë shënime të sakta për përfundimin e detyrave, mësimit në internet dhe projekteve të përunduara në mënyrë efektive nga nxënësit.<br><br>**Mësuesit e Vendosjes së Avancuar do të....**<br>● Ndjekin fushën dhe sekuencën e rekomanduar nga Bordi i Kolegjit<br>● Sigurojnë që të gjithë nxënësit janë duke përdorur platformën AP Classroom në internet dhe burimet e ofruara nga Bordi i Kolegjit<br>● Monitorojnë progresin e nxënësve nëpërmjet platformës dhe komunikojnë progresin e nxënësit me kujdestarët. |

## Vlerësimi & Ndërhyrja

Vlerësimi është një përbërës thelbësor i ciklit të mësimdhënies dhe mësimit të Shkollave Publike Worcester. Plani i vlerësimit të distriktit lejon që distrikti të mbledhë informacione për qëllime të ndryshme. Vlerësimet e krijuara mirë dhe të përdorura siç duhet ofrojnë përfitimet e mëposhtme:

1. Edukatorët marrin informacion mbi pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve
2. Edukatorët mund të vlerësojnë efikasitetin e mësimit të tyre
3. Nxënësit marrin informacion mbi pikat e tyre të forta dhe të dobëta
4. Edukatorët, prindërit/ kujdestarët, dhe nxënësit mund të marrin vendime më të informuara
5. Programet mund të vlerësohen për ndikimin e tyre në të mësuar
6. Shkollat dhe distrikti mund të raportojnë për përparimin akademik

Plani i Vlerësimit të Shkollave Publike Worcester përbëhet nga një larmi vlerësimesh të krijuara për të siguruar informacionin që mësuesit në nivele të ndryshme dhe palët e tjera të interesit (d.m.th. prindërit / kujdestarët, studentët, administratorët) kanë nevojë që të krijojnë me sukses plane dhe politika që plotësojnë nevojat e nxënësve.

Asnjë vlerësim i vetëm nuk i shërben të gjitha qëllimeve, kështu që plani i vlerësimit të distriktit 2020-21 është duke u zhvilluar me qëllimet e mëposhtme:

1. Përdorimin e mjeteve të vlerësimi që janë të vlefshme, të besueshme dhe të përafruara me nivelin e shkallës dhe standardet e përmbajtjes si në mjediset e mësimit në distancë ashtu edhe ato hibride.
2. Balancimin e përdorimit të vlerësimeve formative, diagnostikuese, të përkohshme / standarde, dhe përmbledhëse
3. Mbledhjen e informacionit të mjaftueshëm për njohuritë, aftësitë dhe gadishmësinë e nxënësve që hyjnë në vitin shkollor 2020-21 për të mbështetur mësuesit në rregullimin e mësimit dhe ndërhyrjes.
4. Dhënien e raporte miqësore të të dhënave për përdoruesit për të mbështetur mësuesit në përdorimin e të dhënave dhe komunikimit me palë të ndryshme të interesit.
5. Rritjen e kohës së mësimit dhe shmangien e "testimit të tepërt"

## Mjetet Vlerësuese

Më poshtë janë mjetet lokale të vlerësimit që Shkollat Publike Worcester planifikojnë për t'i përdorur gjatë vitit shkollor 2020-21.

| **Vlerësimo** | **Qëllimi** | **Popullata** |
|---|---|---|
| *Vlerësime të Përbashkëta të Krijuana nga Distrikti* | *I disponueshëm në të gjitha fushat e përmbajtjes dhe i specializuar në bazë të zhvillimit të mësuesit* | *I disponueshëm në të gjitha nivelet e klasave* |
| ALEKS | Vlerëson zotërimin e nxënësit të aftësime matematike të nivelit të klasës | Klasat 9-12 |
| Inventari i Kontrollit të Hershëm (Early Screening Inventory) | Identifikon nxënësit që mund të kenë nevojë për shërbime të edukimit | Klasa K |
| enVision Vlerësimet Online të Temave (Online Topic Assessments) | Vlerëson zotërimin e nxënësit të aftësive matematike të nivelit të klasës | Klasat 3-6 |
| Estructura para la Evaluación del nivel independiente de lectura | Vlerëson nivelin e leximit të nxënësit në Spanjisht | Klasat K-6, dy gjuhëshe dhe programet TBE |
| Fountas dhe Pinnell Sistemi i Vlerësimit të Etapave Kryesore (Benchmark Assessment System) | Vlerëson nivelin e leximit të nxënësit | Klasat K-2 dhe sipas nevojës në klasat më të larta |
| Korniza e Vlerësimit të Nivelit të | Vlerëson nivelin e leximit në | Klasat K-6, dy gjuhëshe dhe |

| | | |
|---|---|---|
| Leximit të Pavarur (Independent Reading Level Assessment Framework) | Anglisht të nxënësit | programet TBE |
| Lexia | Vlerëson progresin e nxënësit në zhvillimin e aftësive të leximit | Klasat K-6 |
| Panorama | Vlerësoni perceptimet e nxënësve për veten dhe ambjentin shkollor të lidhur me fushat e mësimit emocional | Klasat 7-12 |
| SRSD Vlerësimi i Përgjithshëm | Vlerëson zotërimin e nxënësit të aftësime me shkrim të nivelit të klasës | Klasat 3-12 |
| STAR Shkrimi-Leximi i Hershëm/ STAR Shkrimi-Lexim I Hershëm në Spanjisht | Vlerësoni aftësitë e hershme të shkrim-leximit të nxënësve në përgatitjen e leximit | Klasat K-1*<br><br>**nëse një nxënës identifikohet si një lexues i mundshëm ata kalojnë për të marrë STAR Leximin* |
| STAR Leximi/ STAR Leximi Spanjisht | Vlerëson aftësitë e leximit dhe progresin e nxënësit drejt arritjes së etapave të MCAS. | Klasat 2-9 |
| STAR Matematikë/ STAR Matematikë Spanjisht | Vlerëson aftësitë matematike dhe progresin e nxënësit drejt arritjes së etapave të MCAS | Klasat 1-9 |
| ST Matematikë | Vlerëson kuptimin e nxënësve për themelet e temave matematike | Klasat K-6 |

## Mësimi Profesional

Trupi Pedagogjik dhe stafi i Shkollave Publike Worcester do të marrin pjesë në dymbëdhjetë ditë mësimi dhe zhvillimi profesional (PD) duke çuar deri në fillimin e vitit shkollor, nga 27 gusht 2020 - 14 shtator, 2020. Gjatë kësaj kohe, mundësitë do të përfshijnë praktikat dhe procedurat e sigurisë në lidhje me pandeminë, teknologjinë, planifikimin e mësimeve virtuale, mbështetjet kulturore të përgjegjshme social-emocionale dhe mësimet e informuara për traumat për nxënësit në kontekstin e ngjarjeve aktuale.

Mësimi profesional do të ofrohet për të ndihmuar mësuesit të përshtaten me zhvendosjet pedagogjike të kërkuara për planet tona hibride dhe në distancë. Për më tepër, drejtuesit e kurrikulave do të punojnë me

ekipet dhe departamentet për të shkëmbyer planet që janë zhvilluar gjatë verës për të vlerësuar të kuptuarën e nxënësve dhe adresimin e boshllëqeve të të mësuarit gjatë vitit të ardhshëm shkollor.

Gjatë pranverës dhe në vjeshtë, mundësi të gjera të mësimit profesional u janë ofruar dhe do të vazhdojnë t'i ofrohen stafit të Shkollave Publike Worcester. Këto mundësi u ofrohen mësuesve pasi zhvillojnë mësime virtuale, integrojnë teknologji, përfshijnë strategji efektive për një mjedis të fuqishëm virtual të mësimit dhe ndërtojnë komunitete pozitive të të mësuarit nga distanca.

## Prioritetet për Seminaret në Vazhdim Përfshijnë:

| | |
|---|---|
| Mbështetja e Nxënësve<br>● Kontrolli i Disleksisë në Kopsht<br><br>Mbështetja e Mësuesit/ Trajnerit të Fikusuar Mësimor<br>● Lehtësojnë mbledhjet efektive virtuale & komunitetet profesionale të mësimit<br>● Krijojnë një kulturë dhe marrëdhënie në klasë në një mjedis virtual.<br>● Planifikojnë leksione virtule me fokusim në standartet/ angazhimet & zgjedhjet e nxënësit.<br><br>Bazuar në përmbajtje<br>● Fountas & Pinnell Trajnim Imlementuar në Klasë<br>● Platforma Shkencore Gjenerata Gjeniale<br>● Seminare për përmbajtjen e kurrikulës & standartet e praktikës<br>● Webminarë/seminarë mësimi virtual gjithëpërfshirës bazuar në përmbajtje<br>● Koordinatorët e Kurrikulës/ Trajnerët e ndihmës përfshijnë orë vizite<br>● Seminare dhe seanca planifikimi në Nivelin e Klasës/ Specifik në përmbajtje<br>● Planifikim/ instriksion i Vendosjes së Avancuar<br>● AVID struktura e programit & lidhjet | Integrimi i Teknologjisë<br>● Përdorimi efektiv i teknologjisë dhe pedagogjisë për të gjitha modelet e të mësuarit<br>● Seminarët fokusohen në mjetet/ aplikacionet specifike teknologjike<br>● Udhëheqja për Integrimin e teknologjisë<br><br>Nxënësit Disagjuhësh<br>● Letërsia & Mendimi Akademik i Nxënësve të Anglishtes<br>● Zhvillojnë Gjuhën me Gojë nga Shtëpia<br>● Mësim Kulturor I Përgjegjshëm nga Shtëpia: Muzeu prej Meje<br>● Imagjinoni Mësimin: Tutoriali i Gjuhës dhe Shkrimit dhe Leximit<br>● PD Mësuesit e Anglishtes si Gjuha e Dytë (ESL) që u Shërbejnë Nxënësit e Anglishtes (Els) në mjedis të Sub-Ndarë.<br>● Maksimizim i Mësimit në Distancë për Els tanë<br>● WIDA Veprimet Esenciale<br>● Trajnim Bashkë-Mësimor për Mësuesit e Klasave & Mësuesit e ESL<br>● Varietet Gjuhe, Varietet Mësimi<br>● Mbështetjet nge trajnerët ESL Dy Gjuhë Dual (DL) përfshijnë orare vizite. |

## Prioritetet për Trajnim në Gusht për përgatitjen për në Vjeshtë përfshijnë:

- Përmbledhjen e praktikave të sigurisë dhe procedurave që lidhen me pandeminë nga Zyra e Sigurisë Shkollore / koordinatori COVID
- Strategji Efektive/ Praktikat më të Mira për mësimin në distancë /hybrid/online për të gjithë stafin
- 12 orë modulesh të përziera dhe me vetë-rotëm rreth strategjive virtuale të mësimdhënies dhe integrimit të teknologjisë që do të jenë një themel për të gjitha modelet e të mësuarit përfshirë Google Classroom, SeeSaw, strategjive në sinkron dhe asinkron dhe praktikat më të mira, mësimi në klasë, Google Meet dhe më shumë. Të gjithë arsimtarët dhe drejtuesit do të marrin pjesë në një rrugëbazë të të kuptuarit të vetë-drejtuara bazuar në njohuritë, aftësitë dhe pozicionin e tyre.
- Shqyrtimi dhe identifikimi i mjeteve të monitorimit të progresit për stafin e edukimit special për të adresuar performancën e nxënësve për qëllimet dhe objektivat e IEP për të adresuar progresin e nxënësve me aftësi ndryshe.
- Kryetarët e Ekipeve të Vlerësimit dhe Kryetarët e departamenteve të edukimit special do të takohen me ekipe të bazuara në shkollë për të koordinuar një program takimesh për të adresuar afatet e IEP.
- Departamenti i Edukimit Special do të jetë partner me Institutin May për të zhvilluar një seri trajnimesh mbi ndikimin e pandemisë dhe refuzimit të shkollës për stafin e shkollës dhe familjet.
- Mësimi ESL efektiv & strehimit të përmbajtjes (sheltered content) në ambjentin e mësimit virtual
- Zhvillimi i objektivave gjuhësore në nivelin e njësisë dhe ndërtimi sistematik i gjuhës gjatë rrjedhës së njësisë
- Angazhim dhe strategji efektive kur punohet nga distanca me familjet EL
- 'Përqafimi i Shumëgjuhësisë' konferencë për mësimin dygjuhës- Gusht 2020
- PD mund të mbështesë bashkëpunimin midis Sheltered Content Instruction (SCI) dhe mësuesve të ESL.
- Kompania Amerikane e Leximit(ARC) (program shkrimi dhe leximi) PD do të ofrohet mbi 30 ditë këtë vit në të treja shkollat fillore.
- Mësuesit ESL që shërbejnë në programet dygjuhëshe duhet të përfshihen në ARC PD.
- Planifikim dhe seminarë udhëzues për të gjithë partnerët bashkë-mësues për ESL
- PD dhe trajnim shtesë veçanërisht e targetuar nevojitet për Edukimin Kalimtar Dygjuhësh (TBE) dhe DL.
- Mësuesit me licensë të dyfishtë që ofrojnë shërbime ESL nëpërmjet klasave ELA mund të përfitojnë nga PD dhe trajnimi i targetuar.

## Dizajn Universal Për të Mësuarën

Shkollat Publike Worcester përfshinë zbatimin e Dizajnit Universal për të Mësuarën (UDL) si një kornizë për të përmirësuar dhe optimizuar mësimdhënien dhe mësimin për të gjithë. Udhëzimet UDL ofrojnë një seri sugjerimesh konkrete që mund të zbatohen për çdo disiplinë

ose fushë për të siguruar që të gjithë nxënësit të mund të kenë akses dhe të marrin pjesë në mundësi mësimore kuptimplotë dhe sfiduese.

Gjatë verës, drejtorët e distriktit, ndihmësit e drejtorëve, koordinatorët, trajnerët dhe drejtuesit e distriktit lexuan librin "Unlearning" nga Katie Novak & Alison Posey bazuar në parimet dhe praktikën e UDL. Këtë gusht, Katie Novak do të moderojë në Institutin e Udhëheqjes të Shkollave Publike Worcester dhe do të ndajë mënyrat se si liderët mund t'i mbështesin mësuesit për të hartuar dhe ofruar përvoja angazhuese dhe rigoroze të të mësuarit.

## Pedagogjia me Përgjegjësi Kulturore

Shkollat Publike Worcester vënë theksin vazhdimisht në Pedagogjinë me Përgjegjësi Kulturore (CRP) si një kornizë dhe përparësi e distriktit. CRP u përfshi plotësisht në punën tonë drejtuese përgjatë gjithë vitit shkollor 2019-2020 dhe do të vazhdojë në vitin 2020-2021.

Drejtuesit e Shkollave Publike të Worcester-it u përfshinë në trajnime të shumta, anëtarët tanë të nismës së Rrjetit, të gjithë drejtorët e Shkollave Publike Worcester dhe Menaxherët e Zyrave Qendrore morën pjesë në trajnime të ndryshme, seminare dhe sesione të shërbimit në lidhje me CRP. Puna më e gjerë që përfshin iniciativat CRP specifike të shkollës u bë me Shkollën Sullivan MIddle dhe Akademinë Claremont. CRP mbetet përparësi për Shkollat Publike të Worcester dhe janë bërë plane për forcimin dhe thellimin e kësaj pune gjatë vitit të ardhshëm shkollor 2020-2021.

- Drejtuesit pjesëmarrës në iniciativën e Pedagogjisë me Përgjegjësi Kulturore do të vazhdojnë të thellojnë kuptimin e tyre dhe të marrin pjesë në praktika të përgjegjshme kulturore përgjatë gjithë vitit shkollor 2020-2021 duke:
- Eksploruar paragjykimet, supozimet dhe perspektivat për të përfituar një kuptim më të mirë të praktikave të drejta, të përshtatshme, kulturore të rëndësishme që promovojnë mundësitë e të mësuarit të përgjegjshëm dhe me përgjegjësi kulturore në të gjitha shkollat.
- Përcaktuar dhe shpalosur koncepte të kulturës dhe eksploruar implikime të ndjekjes së mësimit me përgjegjësi kulturore në kontekstin e kurrikulës, udhëzimeve dhe vlerësimit.

- Eksploruar spektrin me nxënësin në qëndër të vëmendjes dhe praktikave me përgjegjësi kulturore dhe lëvizjeve pedagogjike të lidhura me komunitetet shkollore të rëndësishme përmes mësimit të vazhdueshëm profesional
- Bashkërenduar njohjen dhe eksplorimim e strategjisë në lidhje me këto praktika dhe promovimi i barazisë racore dhe ndryshimeve në shkolla.
- Identifikuar pikat dhe strategjitë e mundshme të hyrjes për këtë vit shkollor për të promovuar praktikat e përqendruara te nxënësit dhe praktikat me përgjegjësi kulturore në të gjitha shkollat.

## Përdorimi I Të Dhënave Për Të Përmirësuar Rezultatet e Nxënësve Në Mësimin Social-Emocional

Studentët në klasat 7 deri në 12 do të bëjnë anketa përmes Panorama periudha kyçe gjatë vitit. Këto të dhëna, së bashku me Sistemim e Treguesit të Paralajmërimit të Hershëm (EWIS) të shtetit do të mbështesin stafin e shkollës në identifikimin dhe marrjen e veprimeve për të mbështetur nxënësit. Mësuesit do të marrin trajnime për të analizuar dhe vepruar sipas të dhënave për të përmirësuar rezultatet e nxënësve përmes mësimit social-emocional, klimës shkollore dhe hapave të veprimit të angazhimit familjar.

## Zhvillimi i Aftësive: Zgjidhja e Problemeve Bashkëpunuese Collaborative Problem Solving

Ekipet e trajnuara të shkollave tetëvjeçare dhe të mesme si dhe një shkollë fillore do të fillojnë vitin me implementimin e Zgjidhjes së Problemeve Bashkëpunuese. Kjo qasje supozon se nxënësve me sjellje sfiduese u mungon aftësia, dhe jo vullneti, për të pasur sukses. Fokusi është në mësimin e nxënësve të aftësive që do t'I ndihmojë ata në ndërtimin e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe të rriturit në jetën e tyre. Ekipet e bazuara në shkollë do të trainohen dy javë gjatë gjithë vitit për të mbështetur implementimin e suksesshëm.

## Rezistenca & Trauma

Stafi I Shkollave Publike Worcester do të vazhdojnë të marrin trajnime dy herë në muaj për të rritur njohuritë e tyre dhe zbatimin e strategjive për mbështetjen e shëndetit mendor të nxënësve dhe stafit në mësimin në distancë, mësimin hibrid dhe personal. Këshilltarët për rregullimin në shkollë dhe psikologët e shkollës do të mbështesin implementimin.

## Refuzimi I Shkollës

Në partneritet me May Institute dhe Dr. Whitney Kleinert, PhD,BCBA-D. LABA ( Drejtore e Konsultimeve në Shkollë), administratorët, ekipet e bazuara në shkollë, Psikologët, Këshilltarër e Rregullimit në Shkollë, Specialistët e Sjelljes, BCBA dhe familjet do të angazhohen në një seri trajnimesh për të adresuar nevojat e shëndetit mendor të nxënësve që po përjetojnë ankth dhe/ ose frikë gjatë kalimit të

kthimit në shkollë.  Eshtë e rëndësishme të theksohet se sjellja e refuzimit të shkollës prek jo vetëm nxënësin individual, por edhe ata që mbështesin nxënësin, përfshirë stafin e shkollës dhe familjet.

Përfundimi i këtij prezantimi të zhvillimit profesional është të PERCAKTIMI i sjelljes se refuzimit të shkollës dhe **IDENTIFIKIMI** i faktorëve të rrezikut për angazhime në sjelljen e refuzimit të shkollës. Për më tepër, ky prezantim do të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë praktikat më të mira aktuale në **VLERSIMIN** dhe **TRAJTIMIN** e sjelljes së refuzimit të shkollës. Së fundmi, stafi do të angazhohet në këtë mundësi të zhvillimit profesional për të mësuar strategji të bazuara në evidencë për të hartuar strategji proaktive dhe të mundshme për zvogëlimin e gjasave të sjelljes së refuzimit të shkollës kur shkolla në-person të jetë përsëri e disponueshme.

## Mësimi Dixhital dhe Teknologjia

Hulumtimi na tregon se aksesi i kudogjendur në teknologji i shoqëruar me ndërrime pedagogjike në praktikat e përqendruara në nxënësit; të mësuarit aktiv; bashkëpunim; ekuilibëri i menduar midis teknologjisë dhe mësuesit; eksplorim; krijim; dhe mjetet e shumta të angazhimit, shprehjes dhe përfaqësimit, mund të sjellin ndikim në mësimin e nxënësve (Darling-Hammond, Zielezinski, & Goldman, 2014; Ghavifekr & Rosdy, 2015;  Harper, 2018).

Gjatë mësimit në distancë, nxënësit dhe mësuesit u anketuan disa herë në lidhje me përdorimin e teknologjisë për të mbështetur mësimin në distancë. Ne mësuam se seancat e planifikuara sinkrone të fokusuara me qëllim domethënës dhe gjatësi të përshtatshme ishin efektive për mësimin në distancë. Për më tepër, përdorimi i organizuar dhe i përqendruar i mjeteve të aksesit, angazhimi dhe rigoroziteti në mësim, u vlerësuan si nga mësuesit ashtu edhe nga nxënësit. Shumë nxënës raportuan se ata pëlqenin aktivitete të bazuara në projekte të përputhura me standardet e përmbajtjes që lejonin zgjedhje dhe kreativitet. Për të thjeshtëzuar dhe thelluar mësimin profesional të mjeteve dixhitale, stafi do të përdorë mjetet e mëposhtme. Për më tepër, aplikacionet e kurrikulave të miratuara dhe të verifikuara nga distrikti për efektivitetin dhe privatësinë e të dhënave të nxënësve do të vendosen në Clever.

### 1:1 Pajisjet dhe Aksesi i Internetit

Barazia dhe aksesi në teknologjinë e kudogjendur është në pararojë të përparësive tona. Ne shpërndamë laptopë për nxënësit e Kolegjit të Hershëm, dhe chromebook dhe hotspots me një raport 2: 1 për familjet që zgjodhën t'i marrin ato. Për në vjeshtë kemi blerë një pajisje për çdo nxënës. Për më tepër, ne besojmë në teknologji për të gjithë nxënësit dhe kjo përfshin internetin. Ne kemi punuar shumë ngushtë me qytetin dhe komunitetin për të luftuar ndarjen dixhitale. Prioriteti ynë i parë ishte të

siguronim një internet me shpejtësi të lartë përmes Ofruesit tonë të Shërbimit të Internetit, dhe kur kuptuam se nuk do të ishte e mundur, shkuam në rrugën e hotspots.

- Lexo rreth mungesës në Worcester të internetit me bazë të gjerë këtu
- Ne kemi blerë 5000 hotspots me shpejtësi të lartë nga Verizon hotspots për familjet në nevojë
- Ne po vazhdojmë të punojmë me qytetin dhe komunitetin për të advokuar për internet me bazë të gjërë me kosto më të ulët, me një pagues të vetëm, dhe me shpejtësi të lartë.

**Pajisjet**

- 1:1 Cikli Parashkollor Kopshti & Fillimi i Hershëm - iPads
- 1:1 Klasat 1-12+ - Chromebooks

**Mësimi Dixhital dhe Mjetet e Teknologjisë Përfshijnë:**

- PreK-1 SeeSaw (Kërkohet)
- 2-12 Google Classroom (Kërkohet)
- Google Suite: Docs, Drive, Gmail, Kalendar, Classroom, Jamboard
- Screencastify/Screencastify Submit
- Zoom EDU (versioni falas)
- Google Meet (enterprise)
- Google Voice
- Edcite

**Aplikacionet e Kurrikulës në Clever Përfshijnë:**

- Lexia
- ST Math
- Envisions Math
- Brainpop
- Big Ideas Math
- Akademi Khan
- Freckle
- Gjenerata Gjeniale
- Imagine Learning
- myOn (opsione online libri)

## Mbështetje për Integrimin e Teknologjisë dhe Mësimi Profesional

Integrimi i Teknologjisë është përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimin. Ne kemi mësuar që mësuesit vlerësojnë një shumëllojshmëri të zgjedhjeve mësimore, duke përfshirë takime dixhitale, webinar në sinkron, trajnime 1: 1 dhe mundësi të plota vetë-ritmike. Shumica e stafit deklaruan se modeli i të mësuarit që funksionon më mirë për ta është mësimi i përzier, ku ekziston një komponent sinkron, i ndjekur nga mësimi vetë caktim të ritmit me ndihmën dhe bashkëpunimin e

trajnerëve dhe kolegëve. Ne e kuptojmë që për të përmbushur nevojat e të gjithë stafit tonë, duhet të vazhdojmë të ofrojmë të tre opsionet.

Ne jemi duke zhvilluar një seri të zhvillimit profesional të integrimit të teknologjisë për të vazhduar më tej thellimin e punës rreth mësimit në distancë, mësimit të përzier, dhe mësimit të pnrehtë (flipped learning) në mënyrë që mësuesit të mund të kalojnë ndërmjet këtyre mënyrave. Divizioni i mësimdhënies dhe mësimit po punon me zell për të siguruar që nevojat e nxënësve të arsimit special dhe mësuesve të gjuhës angleze të përfshihen në integrimin e teknologjisë. Nga mësuesit dhe drejtuesit pritet të kalojnë në këto module që do të nivelohen dhe bazohen në kërkime, si dhe mësimet e mësuara dhe praktikat premtuese nga mbyllja. Një rrjedhë pune po zhvillohet për të ndihmuar mësuesit të identifikohen ku janë dhe cilat aftësi u duhen të mbështesin integrimin e teknologjisë.

- Modulet me vetë caktim të ritmit të disponueshëm në fund të Gushtit kanë një shumëllojshmëri të nivelimit të prishtshmërive që stafi do ti plotësojë ato do të përfshijnë temat:
    - Përkufizimet dhe të kuptuarin e integrimit të teknologjisë, vazhdimësia e të mësuarit të përzier, mësimi i mprehtë, mësimi online / virtual, sinkron, asinkron
    - Planifikimi me standarte në mendje (Planning with standards in mind) (UBD)
    - TPACK & SAMR
    - Krijimi i Komunitetit në Klasë (Creating Classroom Community)
    - ISTE Standartet e Nxënësit (Student Standards)
    - ISTE Standartet e Mësuesit (Educator Standards)
    - Manaxhimi i ambjentit të mësimit dixhital
    - Modelet e Integrimit të Teknologjisë (Technology Integration Models) (EEE/TIM)
    - Mjetet Dixhitale për të ndihmuar Nxënësit e Gjuhës Angleze
    - Mjetet Dixhitale për të ndihmuar nxënës të ndryshëm
    - Teknologjia Ndihmuese (Assistive Technology)
    - Regjistrim Dixhital I Ekranit të Kompjuterit (Screencasts)
    - Gamification
    - Zgjedhja e mjeteve të duhura (Selecting the right tools)
    - Krijimi i zgjedhjeve në testime/vlerësime (Creating choice in assessments)
    - Mjetet e shumta të përfaqësimit përmes teknologjisë

## Takime të Drejtpërdrejta Ditore (Live Daily Drop In)

- Teknologjia mësimore dhe trainerët e të mësuarit dixhital do të jenë të disponueshme çdo ditë për takime të drejtpërdrejta për stafin, nxënësit dhe familjet.

## Java e Parë e Shkollës

Në mënyrë që të përgatiten për një mbyllje të mundshme dhe të vazhdojnë të përdorin teknologjinë në mënyra kuptimplote, çdo mësuesi do t'i kërkohet të krijojë një ambjent mësimor dixhital për nxënësit e

tyre gjatë javës së parë të shkollës. Ashtu siç një mësues krijon kulturë, pritshmëri, rutina dhe procedura për një mjedis mësimi ballë për ballë, ata gjithashtu duhet ta vendosin këtë për një mjedis online ose të përzier. Për më tepër, mësuesit do të rishikojnë aftësitë me mësuesit e tjerë se si të qasen, të marrin pjesë dhe të paraqesin detyra në internet.

## Privatësia e Të Dhënave të Nxënësve

Ne u bëmë anëtarë të Aleancës për Mbrojtjen e të Dhënave të Nxënësve të MA (SDPA) në maj 2019. SDPA trajton marrëveshjet me mjetet në internet. Ne i marrim shumë seriozisht të dhënat e nxënësve dhe privatësinë e nxënësve. Marrëveshjet përcaktojnë se si kompanitë e teknologjisë mbledhin, ruajnë dhe përdorin të dhënat e nxënësve sipas rregulloreve federale. Ligji për të Drejtat Arsimore Familjare dhe Privatësinë (1974) kërkon që shkollat duhet të kenë leje me shkrim nga kujdestarët në mënyrë që të lëshojnë çdo lloj informacion nga rekordi arsimor i një nxënësi, por lejon shkollat ti zbulojnë ato rekorde, pa pëlqim, për palët e aprovuara ose në kushte të specifikuara arsimore. COPPA, Ligji për Mbrojtjen e Privatësisë Online të Fëmijëve, kërkon më tej të rrisë sigurinë duke kontrolluar se çfarë informacioni mblidhet nga fëmijët e vegjël nga kompanitë që operojnë faqe interneti, lojëra dhe aplikacione celularë drejtuar fëmijëve nën 13 vjeç. Ne jemi në vitin e dytë të zbatimit dhe për këtë arsye kemi nevojë për të krijuar një listë të aplikacioneve të aprovuar. Mësuesve do t'ju kërkohet të paraqesin vetëm aplikacione që nuk janë në këtë listë për t'u verifikuar.

## Video Konferencat

**bit.ly/wpsvideoconference**

Ne do të përdorim Klasa Google (Google Classroom) dhe / ose Zoom për t'ju siguruar mësime në distancë gjatë mbylljes së shkollës. Për të pasur një përvojë të sigurtë dhe mbështetëse për të mësuar në distancë, të gjithë prindërit, kujdestarët dhe nxënësit që marrin pjesë duhet që të pranojnë kushtet e mëposhtme:

Kushtet e të Mësuarit në Distancë me Konferenca Audio dhe Video

Duke marrë pjesë në këtë Klasë Google dhe / ose Zoom si pjesë e planit të mësimit në distancë të fëmijës tuaj, ju pranoni përdorimin e mësimit në distancë me teknologji, mjete dhe shërbime për Konferenca Audio dhe Video, si dhe pranoni që keni lexuar, kuptuar dhe pranuar të gjitha kushtet dhe kufizimet e mëposhtme.

1. Nxënësit dhe prindërit / kujdestarët nuk duhet që të ruajnë, regjistrojnë, shpërndajnë ose postojnë këtë seancë ose kopjet, regjistrimet, materialet ose fotografitë e / nga kjo seancë.
2. Nxënësit duhet që të trajtojnë njëri-tjetrin me respekt. Nxënësit duhet t'u binden rregullave të shkollës në çdo kohë. Kodi i sjelljes së nxënësit vlen për të gjitha seancat e mësimit në distancë. Nxënësit mund të disiplinohen në përputhje me kodin e sjelljes së nxënësve për shkeljen e rregullave të shkollës gjatë seancave. Prindërit / kujdestarët janë

përgjegjës për monitorimin e fëmijëve të tyre gjatë përdorimit të shërbimeve dhe programeve të ofruara.

3. Distrikti rezervon të drejtën që të largojë një nxënës nga një seancë për sjellje të papërshtatshme
4. Gjatë mësimit në internet, informacioni në lidhje me nxënësit dhe / ose zëri, imazhi dhe shkrimi i tyre mund të ndahen me nxënës të tjerë (p.sh., biseda në grup, detyra të përbashkëta, video informuese) të cilët marrin pjesë në seancë. Sidoqoftë, Distrikti ndërmerr hapa për të siguruar që informacioni i regjistrimeve të nxënësve që ai disponon të ruhet në përputhje me ligjet në fuqi
5. Distrikti nuk mban asnjë përgjegjësi dhe nuk bën asnjë pasqyrim në lidhje me cilësinë e shërbimit audio të përdorur në konferencë.
6. Distrikti në mirëbesim është përpjekur të sigurojë që platforma audio-video e konferencave të jetë në përputhje me FERPA, CIPA, COPPA dhe të gjitha ligjet e tjera të zbatueshme federale dhe shtetërore. Distrikti do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur privatësinë tuaj dhe privatësinë e studentit, dhe secili nga arsimtarët tanë do të vazhdojë të ruajë privatësinë e informacionit të regjistrimit të nxënësve. Prindërit / kujdestarët heqin dorë nga të gjitha pretendimet kundër Distriktit në lidhje me përdorimin e këtyre shitësve të palëve të treta që ofrojnë shërbime konferencash audio dhe / ose video.
7. Prindërit / kujdestarët dhe nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm se ata mund të vëzhgohen nga mësuesi dhe nxënësit e tjerë, dhe mund të zgjedhin që të çaktivizojnë funksionin e kamerës.

## Mësimi Dixhital dhe Mbështetja/ Trajnimi i IT për Familjet

Një studim i vjeshtës 2019 tregoi se 60% e familjeve dëshironin të mësojnë më shumë rreth mjeteve dixhitale dhe aplikacioneve që fëmija i tyre përdor në shkollë për të qenë në gjendje t’i mbështesin për detyrat e shtëpisë. Ne po e zgjerojmë mbështetjen që u ofrojmë familjeve dhe po punojmë me stafin,

familjet, nxënësit dhe organizatat e komunitetit për të krijuar një qendër të përditësuar të burimeve të teknologjisë që është më e organizuar dhe miqësore për përdoruesit. Kjo do të ekzistojë në shumë gjuhë. Për më tepër, ne do të caktojmë Webinar-e të drejtpërdrejtë për teknologjisë për familjet e distriktit.

- Akademia Teknologjike Caregiver e Shkollave Publike Worcester (WPS Caregiver Technology Academy)
- Planifikimi i Webminareve të drejtpërdrejtë me familjet për teknologjinë
- Koordinim me partnerët e komunitetit
- Takime dixhitale për ndihmë për të naviguar dhe mësuar rreth aplikacioneve
- Ndihmë IT: Nëse keni një problem me pjesët mekanike të Chromebook-ut tuaj ose keni probleme me hyrjen në llogari, ju lutemi kontaktoni shkollën tuaj për reset-in e fjalëkalimit ose telefononi 508-799-3312 për ndihmë.

## Qëndroni të Informuar, Qëndroni të Shëndetshëm, Qëndroni të Bashkuar

Shkollat Publike Worcester do të vazhdojnë ta përditësuar këtë dokument gjatë vitit për të mbajtur të informuar nxënësit, familjet, stafin dhe partnerët e komunitetit. Ju lutem vizitoni faqen tonë të internetit në worcesterschools.org

## SHTOJCA A

### Përkufizime

**Në Sinkson** – Mësimi në sinkron është një term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar forma të edukimit, arsimimimit, dhe mësimit që ndodhin në të njëjtën kohë, por jo domosdoshmërisht në të njëjtin vend. Ky term më së shumti aplikohet në forma të ndryshme të të mësuarit televizual, dixhital dhe online, në të cilin nxënësit mësojnë nga arsimtarë, kolegë ose bashkëmoshatarë në kohë reale, por jo gjithmonë në person.

- *Komunikimi në Sinkron* – Komunikim ndërmjet dy ose më shumë njerëzish që ndodh në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën hapësirë (qoftë online ose fizike).
- *Mësimi Online në Sinkron* – Mësim në internet që ndodh në të njëjtën kohë për nxënësit ndërsa ata janë duke mësuar/punuar në distancë.

**Asinkron** - Udhëzimet dhe mësimi asinkron ndodhin jo vetëm në vende të ndryshme, por edhe në kohë të ndryshme. Për shembull, mësimet e para-regjistruara në videos, shkëmbimet e email ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, bordet e diskutimit në internet, dhe sistemet e menaxhimit të kursit që organizojnë materiale mësimore dhe korrespodencat përkatëse, të gjitha do të konsideroheshin forma të të mësuarit asinkron.

- *Komunikimi Asinkron* - Komunikim ndërmjet dy ose më shumë njerëzish që ndodh në intervale të ndryshme me pjesëmarrës në vende të ndryshme.
- *Mësime Asinkron Online* – Mësim në internet që nuk ofrohet në të njëjtën kohë dhe vend për të gjithë nxënësit; mësim në internet me vetë-përcaktim të ritmit.

**Në Distancë** - Mësimi në distancë është kur nxënësi dhe mësuesi, ose burimi i informacionit, nuk janë fizikisht të pranishëm në një mjedis tradicional në klasë. Informacioni transmetohet përmes

teknologjisë, siç janë bordet e diskutimit, video konferencat, dhe vlerësimet në internet. Mësimi në distancë mund të ndodhë në mënyrë sinkronike me bashkëveprim të nxënësve në kohë reale, ose në mënyrë asinkronike, me aktivitete mësimore me vetë-përcaktim të ritmit që zhvillohen në mënyrë të pavarur nga mësuesi.

- *Mësimi Online* – kombinim i mësimeve dhe vlerësimeve që ndodhin në internet; ndonjëhere referuar si mësim në distancë.

**Hibrid** – Mësim që ndodh si në internet ashtu edhe në një vendodhje fizike. Aktivitetet në internet dhe ato në person integrohen në një përvojë kohezive mësimore.

- *Mësim i Përzjerë* - një mënyrë për të kombinuar eksperiencat tradicionale në klasë dhe mësimin dixhitale që vënë theksin në përdorimin e opsionit më të mirë për të përmbushur objektivat e të mësuarit .
- *Mësimi Dixhital* - kombinimi i mësimeve dhe vlerësimeve që përdor mjete dixhitale për të mbështetur mësimin e nxënësve; mund të ndodhë brenda ose jashtë klasës.

**Sistem i Manaxhimit të Mësimit (Learning management system) (LMS)** - Një aplikim për krijimin dhe dhënien e klasave mësimore. Mësuesit mund të japin përmbajtje, të administrojnë vlerësime dhe të monitorojnë përparimin e nxënësve. Nxënësit mund të hyjnë në materialet e klasës dhe të marrin pjesë në përvojat e mësimit në internet. LMS mund të përdoret në një mjedis të mësuar të përzier ose plotësisht online. Në Worcester, ne jemi duke përdorur Google Classroom dhe Seesaw si sistemet tona të menaxhimit të të mësuarit.

**Pajisje** - Një mjet elektronik që përdoret për të hyrë në internet ose për të përfunduar detyra dixhitale. Kjo mund të përfshijë një desktop, laptop, chromebook, tablet, smartphone dhe mjete të tjera të ngjashme. Në Worcester, ne kryesisht përdorim chromebook dhe tableta iPad.

## Akronime

ABA- Analist i Sjelljeve të Aplikuara (Applied Behavior Analyst)

BCBA- Analist Sjelljeje i Certifikuar nga Bordi (Board Certified Behavioral Analyst))

CDC-Qëndra pë Kontrollin e Sëmundjeve (Center for Disease Control)

CIPA- Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve në Internet (Children's Internet Protection Act)

CNA- Ndihmë Infermjer i Certifikuar (Certified Nurse Assistant)

COPPA- Ligji i Mbrojtjes Online i Privatësisë së Fëmijëve (Children's Online Privacy Protection Act)

CPI- Instituti i Parandalimit të Krizave (Crisis Prevention Institute)

CPT- Kohë e Zakonshme Planifikimi (Common Planning Time)

CRP- Pedagogji me Përgjegjësi Kulturore (Culturally Responsive Pedagogy)

DESE- Departamenti I Massachusetts I Arsimit Fillor dhe të Mesëm

DL- Dy Gjuhë (Dual Language)

EL- Nxënës i Gjuhës Angleze (English Learner)

ELA- Artet e Gjuhës Angleze (English Language Arts)

ELPAC- Këshilli Këshillues i Prindërve të Nxënësve të Gjuhës Angleze (English Learners Parent Advisory Council)

EPL- Niveli i Aftësisë në Anglisht (English Proficiency Level)

ESL- Anglishtja si Gjuha e Dytë (English as a Second Language)

FAPE – Arsim Publik Falas dhe i Përshtatshëm (Free and Appropriate Public Education)

FERPA- Ligji I të Drejtave & Privatësisë për Edukimin e Familjes (Family Educational Rights & Privacy Act)

HVAC- Ngrohje Ventilim & Ajër i Kondicionuar (Heating Ventilation & Air Conditioning)

IEP- Plan Edukativ i Individualizuar (Individualized Education Plan)

ISTE- Shoqëria Ndërkombëtare për Teknologjinë në Arsim, standarte të njohura ndërkombëtarisht për integrimin teknologjik, njohuritë dhe aftësitë për nxënësit, mësuesit dhe drejtuesit.

IT- Teknologji Informacioni

LPN- Infermjere Praktike e Liçensuar (Licensed Practical Nurse)

PBIS- Ndërhyrjet dhe Mbështetjet e Sjelljes Pozitive (Positive Behavioral Interventions and Supports)

PD- Zhvillim Profesional/Mësim Profesional

PLC- Komunitete të Mësimit Profesional (Professional Learning Communities)

PPE- Pajisje Mbrojtëse Personale (Personal Protective Equipment)

RTI- Përgjigja Ndaj Ndërhyrjes (Response To Intervention)

SAMR- Një kornizë që bën integrimin e teknologjisë që kategorizon katër shkallë të ndryshme të integrimit të teknologjisë në klasë. Shkronjat "SAMR" nënkuptojnë Zëvendësimin, Shtimin, Modifikimin dhe Përcaktimin.

SCI- Mësime të Strehuara të Përmbajtjes (Sheltered Content Instruction)

SDI- Mësime të Hartuara Posaçërisht (Specially Designed Instruction)

SEI- Imersion i Strehuar I Anglishtes (Sheltered English Immersion)

SEL – Mësimi Social Emocional (Social Emotional Learning)

SLIFE- Nxënësit me Mësim Formal të Kufizuar të Ndërprerë (Students with Limited Interrupted Formal Education)

SPED- Edukimi Special (Special Education)

SWD- Nxënësit me Paaftësi (Students with Disabilities)

TBE- Edukimi Kalimtar Dygjuhësh (Transitional Bilingual Education)

TPACK- Njohuri për Përmbajtjen Pedagogjike Teknologjike (Technological Pedagogical Content Knowledge), është një model që ndihmon mësuesit të konsiderojnë se si fushat e njohurive së tyre kryqëzohen në mënyrë që të mësojnë dhe angazhojnë nxënësit efektivisht me teknologjinë.

WPS – Shkollat Publike Worcester (Worcester Public Schools)